

DORACAK



PËR



SHOFER

FILLESTAR



D O R A C A K

PËR SHOFER FILLESTAR



Botues:

Këshilli Republikan për Siguri në Komunikacionin Rrugor
i Republikës së Maqedonisë së Veriut
www.rsbsp.org.mk

**DORACAK
PËR SHOFER FILLESTAR**

Autorë:

mr. Gordana Kozhuvarovska
mr. Zllatko Angellkovski
inxh. diplo. Riste Josifovski

Bashkëpunëtorë profesionalë:

Vlladimir Llazarov
mr. Risto Maņev
inxh. diplo. komunik. Kiro Ristovski

Shkup, 2021

copyright © KRSKRR, 2021

PËRMBAJTJA

Parathënie	5
Këshilla për shoferin fillestar - Përgatitja për të ngasur	8
Kushtet për të ngasur automjetin	14
RESPEKTOJI kufizimet për shofer fillestar	16
RESPEKTOJI rregullat e komunikacionit rrugor dhe dispozitat themelore	18
RESPEKTOJI veprimet me automjetin në komunikacion	20
RESPEKTOJI rregullat për lëvizjen e automjeteve në rrugë	21
RESPEKTOJE kufizimin dhe rregullimin e shpejtësisë së lëvizjes	26
RESPEKTOJI rregullat e kthimit	29
RESPEKTOJI rregullat se kush ka përparësi kalimi	33
RESPEKTOJI rregullat e komunikacionit në udhëkryq	35
RESPEKTOJI rregullat e komunikacionit në udhëkryq me rrethrotullim në komunikacion	39
RESPEKTOJI rregullat e kalimit	41
RESPEKTOJI rregullat e parakalimit dhe kalimit	46
RESPEKTOJI rregullat e ndalimit dhe parkimit	58
Parking-zona të sigurta familjare	69
RESPEKTOJI rregullat e tërheqjes së rimorkios dhe mjetit mbrehës	70
RESPEKTOJI rregullat e tërheqjes së automjetit me defekt	71
RESPEKTOJI rregullat e përdorimit të dritave në komunikacion	75
RESPEKTOJI rregullat e distancës midis automjeteve	76
RESPEKTOJE obligimin e shoferëve ndaj këmbësorëve	77
RESPEKTOJI rregullat e komunikacionit për kalimin e rrugës nëpërmjet vijës hekurudhore	80
RESPEKTOJI rregullat e komunikacionit në autostradë, rrugën ekspres dhe në rrugën e rezervuar për komunikacionin e automjeteve	82
RESPEKTOJI rregullat e komunikacionit në tunel	89
RESPEKTOJI rregullat e automjeteve në shoqërim	90
RESPEKTOJI rregullat e automjeteve me përparësi kalimi	94
RESPEKTOJI rregullat e transportit të personave me automjete	96
RESPEKTOJI shenjat që pjesëmarrësve në komunikacionin rrugor ua japin nëpunësit policorë të uniformuar të Ministrisë së Punëve të Brendshme	99
Detyrat në rast të fatkeqësisë së komunikacionit	103
Shkaqet më të zakonshme të fatkeqësive në komunikacion në të cilat pësojnë shoferët e rinj, përkatësisht shoferët fillestarë	108
Shenjat e komunikacionit	111
Konkluzioni	157
Literatura e shfrytëzuar	159

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

656.13.05(035)

КОЖУВАРОВСКА, Гордана

Прирачник за возач почетник / [автори Гордана Кожуваровска, Златко Ангелковски, Ристе Јосифовски ; стручни соработници Владимир Лазаров, Ристо Манчев]. - Скопје : Републички совет за безбедност на сообраќајот на патиштата на Република Северна Македонија, 2021. - 160 стр. : илустр. ; 25 см

Библиографија: стр. 159

ISBN 978-608-4920-01-4

1. Ангелковски, Златко [автор] 2. Јосифовски, Ристе [автор]
а) Патен сообраќај -- Возачи, почетници -- Безбедност -- Прирачници

COBISS.MK-ID 53777157

PARATHËNIE

Komunikacioni rrugor është segment i rëndësishëm për prosperitetin ekonomik, zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të çdo vendi. E ardhmja dhe zhvillimi i një vendi nuk mund të arrihet pa siguruar komunikacion të sigurt dhe të qetë.

Numri i automjeteve, numri i shoferëve dhe intensiteti i komunikacionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut edhe në nivel botëror po rritet vazhdimisht, dhe në të njëjtën kohë, për fat të keq, fatkeqësitë e komunikacionit po bëhen përditshmëria jonë. Epidemia globale e viktimave në fatkeqësitë e komunikacionit që ka prekur botën në vitet e fundit, nuk e ka kaluar edhe Republikën e Maqedonisë së Veriut. Numri i madh i jetëve të humbura njerëzore në fatkeqësitë e komunikacionit është një humbje e rëndë dhe e pakompensueshme shoqërore. Nuk mund dhe nuk guxojmë ta pranojmë këtë gjendje të rrugëve si realitet mizor dhe të pashmangshëm me të cilin nuk mund të përballemi, por përkundrazi - kjo statistikë e zezë na sfidon më tej dhe na detyron të gjithë neve, si pjesëmarrës aktivë dhe pasivë në komunikacion, të japim kontributin tonë në procesin e përmirësimit të sigurisë në komunikacionin rrugor.

Çdo individ me përgjegjësi shoqërore ka për obligim të japë kontributin e tij për komunikacion më të sigurt, së pari si pjesëmarrës në komunikacion, përmes respektimit maksimal, të plotë, të vazhdueshëm dhe të pakushtëzuar të rregullave të komunikacionit, dhe pastaj edhe si qenie shoqërore, faktor që përpiqet për ndërgjegjësimin mbi pjesëmarrjen e përgjegjshme në komunikacion dhe për avancimin e kulturës, etikës dhe shprehive të sjelljes në komunikacion.

Përgjegjësia personale e secilit individ, i cili në çfarëdo mënyre merr pjesë në komunikacion, veçohet si përgjegjësia primare për sigurinë e përgjithshme në komunikacionin rrugor. Duke pasur parasysh pasojat e ngasjes së papërgjegjshme, përgjegjësia e shoferëve spikat si hallka më e lartë dhe më e rëndësishme në procesin e përmirësimit të sigurisë rrugore.

Si shofer fillestar duhet të dini se përgjegjësia juaj për sigurinë në komunikacion është e madhe. Fatkeqësitë e komunikacionit nuk janë fati i jetës së dikujt, por janë pasojë e pjesëmarrjes së papërgjegjshme në komunikacion dhe mosrespektimit të rregullave të komunikacionit.

Fatkeqësitë e komunikacionit janë një nga shkaqet kryesore të vdekjes së njerëzve, veçanërisht të rinjve. Në nivel botëror, sipas statistikave zyrtare, 1.25 milion njerëz vdesin çdo vit në fatkeqësi komunikacioni, nga të cilët rreth 25% janë të rinj të moshës deri 29 vjeç. Rreth 50 milion persona në vit pësojnë lëndime të rënda trupore, prej të cilëve një numër i madh me invaliditet të përhershëm, gjithashtu si rezultat i pjesëmarrjes së papërgjegjshme në komunikacion.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, mesatarisht 150 persona në vit humbin jetën në fatkeqësi komunikacioni.

Në përputhje me të theksuarën më lartë, dhe me qëllim të avancimit të sigurisë në komunikacionin rrugor si çështje me interes më të gjerë shoqëror, Këshilli Republikan për Siguri në Komunikacionin Rrugor në punën e tij vë theks të veçantë tek shoferët e rinj dhe shoferët fillestarë, si grup i rrezikshëm dhe vunerabilë i pjesëmarrësve në komunikacion, dhe me qëllim të edukimit të tyre në lidhje me rregullat e komunikacionit, por edhe edukimin e tyre për respektimin e normave morale dhe etike në komunikacion.

Çdo shofer fillestar duhet të jetë i vetëdijshëm se patentë shoferi - e drejta për të ngasur automjetin - është përgjegjësi e besuar e familjes dhe shoqërisë. Kjo do të thotë që familja dhe shoqëria e shoferit fillestar njohin personin e pjekur, të vetëdijshëm dhe të ndërgjegjshëm, përkatësisht personin që di të vlerësojë jetën dhe vlerat pozitive në shoqëri. Të marrësh pjesë në komunikacion si shofer do të thotë të shfaqësh përgjegjësi dhe t'i respektosh rregullat e komunikacionit, kudo dhe gjithmonë.

Materia që rregullon komunikacionin rrugor është e gjerë dhe komplekse dhe në formën e zgjidhjes ligjore përcaktohet në Ligjin për siguri në komunikacionin rrugor dhe çdo shofer duhet t'i dijë dhe t'i respektojë dispozitat e ligjit në fjalë. Si institucion që është i vetëdijshëm për rreziqet në komunikacionin, por njëkohësisht edhe përgjegjës për të vepruar në parandalimin e tyre, me qëllim të përvetësimit dhe avancimit të njohurive të kandidatëve për shoferë dhe shoferë fillestarë dhe lehtësimit të procesit të edukimit dhe aftësimit të kandidatëve për shoferë dhe shoferë fillestarë, KRSKRR-ja hartoi "Doracak për shoferë fillestarë" i cili ilustron në mënyrë të gjallë, të qartë dhe të kuptueshme rregullat "më të rëndësishme" që kandidatët e shoferëve të kategorisë "B" dhe shoferët fillestarë duhet t'i dinë dhe t'i respektojnë.

Secili proces i të mësuarit është sfidë unike dhe e ndryshme për secilin person. Kuptimi dhe zbatimi i asaj që është mësuar është provë se informatat dhe aftësitë e reja janë miratuar / zotëruar si duhet dhe e gjithë kjo shihet në praktikë përmes rezultateve të mira. E njëjta gjë vlen edhe për shoferët fillestarë.

Nuk bëhesh shofer i mirë vetëm duke dhënë provimin për të ngasur automjetin dhe duke marrë patentë shoferin. Patentë shoferi është provë se shoferi ka njohuritë dhe aftësitë minimale të nevojshme për të marrë pjesë në komunikacion, ndërsa për t'u bërë shofer i mirë nevojiten vite praktikë dhe përvojë.

Ngasja e automjetit është aktivitet kompleks dhe i ndërlikuar që nënkupton kryerjen e disa aktiviteteve fizike dhe mendore në të njëjtën kohë, dhe kryerja e tyre e suksesshme dhe e sigurt kërkon përqendrim, njohuri dhe përvojë. Në procesin e ngasjes, shoferi zgjidh vazhdimisht situata të reja të panjohura, gjë që kërkon përqendrim dhe tendosje maksimale psikofizike. Çdo gabim në ngasjen e automjetit mund të shkaktojë fatkeqësi komunikacioni, me dëm material, lëndime ose vdekje - për ju, për ata që janë me ju dhe për të gjithë pjesëmarrësit e tjerë në fatkeqësinë e komunikacionit.

Automjeti sot nuk është luks, por nevojë e domosdoshme e jetesës moderne. Prandaj, të kesh patentë shofer dhe të ngasësh automjet është nevojë e domosdoshme, e cila është punë komplekse dhe e përgjegjshme, e shoqëruar me rreziqe.

Sipas statistikës dhe përvojës, shoferët fillestarë i përkasin grupit të pjesëmarrësve të rrezikshëm në komunikacion dhe për këtë arsye ligji parashikon kufizime të caktuara për këtë kategori të pjesëmarrësve në komunikacion: në mënyrë që të mundësojë azhurnimin gradual të njohurive dhe aftësive të tyre dhe integrimin e tyre gradual dhe të sigurt në sistemin kompleks dhe dinamik të komunikacionit.

Për të lehtësuar të gjithë këtë proces, KRSKRR-ja ka hartuar "Doracak për shoferë fillestarë" i cili është mirë i sistemuar dhe kujtesë e gjallë e obligimeve ligjore dhe metodike për çdo shofer fillestar, për zotërimin më të lehtë të fazës së parë të ngasjes në karrierën e shoferit - shoferit fillestar.

KËSHILLA PËR SHOFERIN FILLESTAR PËRGATITJA PËR TË NGASUR



Fotografia 1

Marrja e patentë shoferit është sigurisht një nga momentet më të rëndësishme në jetën e të rinjve, veçanërisht nëse merret parasysh sa të vështira dhe të gjata janë trajnimet në autoshkollat, si dhe peshat e dhënies së provimit të ngasjes së automjetit. Sidoqoftë, pa marrë parasysh se sa i mirë dhe thelbësor është trajnimi i shoferëve të rinj në autoshkollë, provimi i vërtetë për shoferët fillestarë është të ngasin nëpër qytet vetëm, automjetin e tyre, pa instruktor.

Herën e parë ndoshta do të keni frikë. Kjo është ndjenjë normale që shoqëron çdo shofer fillestar, sepse ngasja e automjetit nuk është aq e lehtë. Nëse konsideroni se nuk jeni gati për të ngasur, është më mirë ta lini për më vonë. Uluni pas timonit vetëm për herë të parë kur do të ndiheni gati. (Foto. 1)

Nëse dëshironi të merrni pjesë në mënyrë të sigurt dhe efikase në komunikacionin rrugor, si dhe të mos jeni pengesë për pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion, duhet të mendoni vazhdimisht për atë që po bëni. Duhet të përqendroheshi në ngasjen e automjetit, t'i mbani sytë hapur dhe të parashikoni se çfarë do të bëni në minutat e ardhshme.

Si fillestar, mos imitoni shofer me përvojë. Ngisni sipas aftësive tuaja, që do të thotë që kryesisht uleni shpejtësinë dhe përmbajuni kufijve të

përcaktuar. Për fillim, ulja e shpejtësisë do t'ju japë më shumë kohë për të menduar dhe për të reaguar si duhet ndaj situatave të paparashikuara. Mos u dekurajoni nëse ju tejkalojnë automjetet e tjera. Edhe nëse ngisni shumë ngadalë, sipas tyre, keni të drejtë ta bëni këtë. Kjo shpejtësi është veçanërisht e rëndësishme për kryerjen e çdo manovre. Vini re se disa pengesa janë aq të ulëta sa nuk mund të shihen nga dritarja e automjetit.

Mos u shqetësoni për fishkëllimin e shoferëve të tjerë, gjestikulimet ndaj jush dhe "ngjitjen në parakolpin e pasmë". Asnjëherë mos nxitoni dhe mos i humbni "nervat" për shkak të tyre. Gjithashtu, si fillestarë, mbani distancë më të madhe nga shoferët me përvojë. Jini të vetëdijshëm se në situatë kritike nuk do të reagoni aq shpejt ose saktë si shofer me përvojë, kështu që lini pak më shumë "tampon zonë". Mos kini turp të ngisni me njerëz më me përvojë, siç janë prindërit tuaj, dhe t'i dëgjoni këshillat e tyre për të ngasur. Ju jeni fillestar dhe jini të vetëdijshëm për këtë.

Edhe pse ngasja është "shprehi" për shoferin me përvojë dhe "gjëja më e thjeshtë në botë", ngasja e automjetit është ende aktivitet kompleks. Të gjithë shoferët me përvojë dikur ishin fillestarë, nuk ishin aspak të aftë, shpesh ishin të frikësuar nga automjeti i tyre dhe pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion. Kjo mungesë aftësie, pasigurie dhe frike, është diçka që shoferët e ndryshëm fillestarë e kapërcejnë në mënyra të ndryshme. Për disa, ngasja e automjetit bëhet "shprehi" pas vetëm disa muajsh, ndërsa të tjerët do të mbeten të pasigurt dhe të ngathët për vite të tëra, ndoshta gjatë gjithë "karrierës së tyre të ngasjes".

Kur ngisni në rrugë, mbani vendosmërinë dhe besimin tuaj. Nuk mund të lejoni momentin e hezitimit. Nëse keni nevojë të kaloni një kohë të gjatë ose të bëni ndryshim të caktuar, në fund do të mësoni se si ta vlerësoni siç duhet distancën. Shoferi që nuk është i sigurt në aftësitë e tij nuk mund të bëhet shofer i mirë. Vetëbesimi fitohet gradualisht, duke mësuar vazhdimisht në komunikacion, duke hequr qafe frikën dhe duke njohur automjetin tuaj. Me kalimin e kohës, relaksimi rritet derisa shoferi të bëhet "plotësisht i sigurt" në aftësitë e tij të ngasjes. Por, ky vetëbesim fsheh edhe shumë rreziqe. Duhet të jeni të vetëdijshëm për rreziqet e komunikacionit në çdo kohë dhe kurrë të mos relaksoheni plotësisht dhe të imagjinoni se jeni shofer mjaft i mirë.

Nuk jemi të gjithë shoferë të lindur. Nuk jemi të gjithë njëjtë të aftë, dhe cilësitë tona fizike dhe mendore janë të ndryshme. Dhe kjo është diçka që duhet ta keni gjithmonë në mendje kur jeni pas timonit, veçanërisht shoferët e rinj. Në vitet e fundit, ligji ka përcaktuar qartë se çfarë duhet të respektojnë shoferët fillestarë dhe çfarë kufizimesh kanë, duke filluar nga fuqia e motorit të automjetit që ngasin dhe deri në kufizimet kohore.

Pak shoferë janë trajnuar në të njëjtin lloj të automjetit siç e kanë edhe privatisht. Prandaj, këshilla e parë - e cila vlen edhe nëse jeni trajnuar në të njëjtin automjet - është t'i studioni të gjitha tiparet e automjetit tuaj: të gjitha funksionet dhe pajisjet që i ka. Provoni çdo buton, levë, çelës. Hiqeni dhe zëvendësojeni gomën rezervë. Simuloni ndërrimin e gomës, kontrolloni se ku ndodhen siguresat, llambat rezervë, nëse keni të gjitha pajisjet e

përcaktuara të detyrueshme në automjet. Nëse i keni mjetet e nevojshme, ndihmën e parë. Provoni t'i hiqni ose instaloni fshirëset e dritareve, shikoni nëse dhe si t'i përdorni dritat, nëse është e mundur të zëvendësoni llambën në automjetin tuaj apo jo.

Për fillestarët, mbani mend llojin e karburantit që përdor automjeti juaj. Nëse dyshoni ose nëse automjeti nuk është i juaji, shikoni në patentë shoferin ose kontrolloni se çfarë është shkruar në brendësinë e kapakut të rezervuarit. Gjithmonë ekziston një lloj i shënuar i karburantit i lejuar për automjetin. Përveç kësaj, është e vështirë të futësh "armë" më të trashë dizeli në rezervuarin e benzinës, por "arma" e benzinës më e hollë gjithmonë hyn në vrimën e dizelit pa ndonjë problem. Në rast gabimi, mos e ndizni automjetin dhe zbrazeni rezervuarin menjëherë.

Mësoni edhe pajisjet kontrolluese të automjetit, kontrolloni në detaje se si funksionojnë funksionet e caktuara të pajisjes audio, kondicionerit, fshirëseve... Shoferët më me përvojë, të tillë si prindërit, mund t'ju ndihmojnë pjesërisht, por do të mësoni më shumë nga udhëzimi për ngasjen e automjetit. Çdo buton dhe çdo detaj aty përshkruhet me hollësi, dhe nga udhëzimet do të mësoni shumë detaje më interesante për automjetin tuaj dhe do të zbuloni tipare të reja për të cilat nuk keni ditur. Duke njohur automjetin, fitoni edhe vetëbesim dhe aftësi të ngasjes.

Kur hyni në automjet, gjithmonë kontrolloni gjendjen e gomave, pozicionin e gomave. Të paktën një herë në javë, për fillim, çojeni kofanen, kontrolloni nivelin e vajit, kontrolloni nivelin e të gjitha lëngjeve. Këto aktivitete janë shumë të thjeshta, gjithçka shpjegohet bukur në udhëzimet e automjetit dhe çdo shofer pak më me përvojë mund t'ju ndihmojë. Më vonë, e gjithë kjo do të bëhet rutinë për ju dhe do të mësoni t'i zgjidhni problemet shpejt.

Të ulurit duhet të jetë i rehatshëm, jeni mësuar për këtë në autoskollë, por në çdo automjet pozicioni ideal i të ulurit është i ndryshëm. Kujdesuni për veten tuaj derisa të gjeni pozicionin ideal të sediljes dhe rregullojeni mirë timonin. Jo vetëm që do të ndiheni më rehat dhe do të keni dukshmëri më të mirë, por me pozicionin e duhur të uljes do të keni reagime më të shpejta në situata krizash, sepse pozicioni i trupit dhe i krahëve është i tillë që kthimi i timonit dhe shtypja e pedalit do të jetë më e shpejtë sesa nëse uleni gabimisht.

Rregulloni retrovizorët e brendshëm dhe të jashtëm.

Sigurisht, mos harroni të lidhni rripin e sigurimit para se të ndizni automjetin.

Në tabelën e instrumenteve, çdo automjet ka dhjetëra sinjale "drite" dhe paralajmërimi. Kur ndizet diçka e papritur, ndaluni në vend të sigurt dhe kontrolloni udhëzimet se çfarë do të thotë sinjali i tillë. Si rregull, "dritat" e verdha janë shenjë e problemit të vogël me të cilin mund të vazhdoni të ngisni, ndërsa ngjyra e kuqe tregon problem të madh, që do të thotë se automjeti duhet të ndalet.

Kujtojini vetes se çfarë nënkuptojnë dritat në tabelën e instrumenteve! (Tabela 1)

	Drita e pozicionit		Treguesi i drejtimeve
	Dritat e mesme		Drita e gjatë
	Dritat e përparme të mjegullës		Dritat e pasme të mjegullës
	Presioni i pamjaftueshëm i vajit të motorit		Karikimi i pamjaftueshëm i akumulatorit
	Niveli minimal i vajit të motorit		Problemet me sistemin e ftohjes së motorit
	Niveli i ulët i lëngut të frenimit ose frenimi i bllokuar i dorës		Frenimi i aktivizuar i dorës (parkimit)
	Dritat e rasteve urgjente - të gjithë vezulluesit e ndezur		Drita e treguesit për defektin në elektronikë
	Defekti në jastëkët e ajrit		Dera e hapur e automjetit
	Rezerva e karburantit		Defekti i sistemit ESP
	Defekti i sistemit të injektimit ose motorit		Ngrohëset me motor dizel të aktivizuar
	Defekti i sistemit ABS		Jastëku i ajrit i çaktivizuar
	Kontrolloni presionin e gomave		Amortizimi i bazës së frenave
	Defekti i sensorëve të parkimit		Sinjalizimi i përgjithshëm.
	Kontrolli aktiv i shpejtësisë konstante		Defekti i dritave të jashtme

Tabela 1

Mësoni bazat e mekanikës së automjeteve që çdo shofer duhet t'i dijë.

Ngasja e sigurt do të thotë të përdorni pothuajse të gjitha shqisat tuaja, në të gjitha kushtet e ngasjes. Shikimi është sigurisht më i rëndësishmi, por duhet të mësoni se si të shikoni rrugën dhe komunikacionin. Nuk mjafton vetëm të shihni atë përpara jush. Shoferi i aftë shikon në distancë, duke ndjekur komunikacionin e disa automjeteve përpara tij ose edhe disa qindra metra përpara tij në rrugë të hapur. Shqisa e të dëgjuarit është gjithashtu shumë e rëndësishme. Me të, do të vini re sa më shpejt që dikush po frenon papritmas, që po afrohet ambulanca ose dikush po ju paralajmëron për rrezik me sirenë. Kjo është arsyeja pse është shumë e rëndësishme të mos e teproni me volumin e muzikës që dëgjoni në automjet gjatë ngasjes, veçanërisht nëse jeni shofer fillestar. Gjithashtu, shqisa e nuhatjes është shumë e rëndësishme sepse mund ta përdorni për të regjistruar se diçka nuk është në rregull me automjetin, për shembull, nëse diçka është prishur apo edhe ka marrë flakë. Më në fund, ekziston e ashtuquajtura "shqisa e gjashtë". Është shumë e rëndësishme të përpiqeni të parashikoni se çfarë mund të bëjnë pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion dhe kështu t'u shmangeni situatave të rrezikshme. Intuita e ngasjes fitohet kryesisht përmes përvojës së ngasjes në të gjitha kushtet. Me kilometra të kaluara, shumica e shoferëve zotërojnë teknikën e parashikimit dhe, siç shoferët e tjerë ngasin, ata shpesh parashikojnë situatën që mund të shkaktojë.

Kur ngisni, është shumë e rëndësishme, përveç respektimit të rregullave të komunikacionit, të jeni maksimalisht të përqendruar. Shmangni bisedën me pasagjerët në automjet, mos përdorni celular. Asnjëherë mos garoni me shoferin tjetër. Lëshojeni nëse lëviz afër jush, nëse ju sinjalizon t'ia lëshoni rrugën, edhe nëse jeni duke ngasur me shpejtësinë e lejuar. Ju nuk jeni të detyruar ta kritikoni dhe dënoni atë.

Kujdesuni që të shikoni anash mbi supe, majtas ose djathtas para çdo ndryshimi të drejtimit dhe gjithmonë mos u mbështetni vetëm në pasqyrat. Monitoroni komunikacionin përreth jush, parashikoni veprime dhe aktivitete të ndryshme, tejkalimin bëjeni në kohën e duhur, ndaloni nëse është e nevojshme. Nëse kthimi është i rrezikshëm, është më mirë të vazhdoni sesa të frenoni befás dhe të ndryshoni drejtimin e lëvizjes.

Kontrolloni dy herë para se të filloni t'i tejkaloni automjetet e tjera. Gjithmonë mbani në mend se korsia juaj është e djathtë, natyrisht nëse nuk është "e verdhë" dhe se korsia e majtë, korsia "më e shpejtë", si rregull, në qytet dhe jo vetëm në rrugë, shërben për të parakaluar.

Edhe pse ndonjëherë është vërtet e vështirë të përmbaheni, përpiquni të përdorni sirenën sa më pak të jetë e mundur si "protestë", sepse shkakton ankth tek disa shoferë - reagimi i panevojshëm që mund të jetë i rrezikshëm për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion. Mbani mend se mund ta përdorni sirenën sipas ligjit në raste të përcaktuara në mënyrë rigoroze, të tilla si, për shembull, ngasja në kthesë të padukshme.

Kur parkoni, zgjidhni vend që ka qasje të lehtë dhe dalje edhe më të lehtë. Gjithmonë përdorni "frenin e parkimit" për parkim. Nuk mjafton vetëm vendosja e marshit në shpejtësi. Sigurisht, përjashtimi është në dimër në temperatura të ulëta, sepse atëherë mekanizmi mund të "bllokohet".

Është më mirë të shmangni ngasjen nëpër pjesë të panjohura të qytetit për muajt e parë dhe të mos bëni udhëtime të gjata. Ngisni sa më shpesh të jetë e mundur përgjatë trasesë të cilën e njihni mirë. Hulumtimet tregojnë se kur shoferi ngas për herë të parë në rrugë të caktuar, veçanërisht përmes qytetit, ai është i përqendruar në drejtim të lëvizjes, shenjat e komunikacionit i ndjek më pak dhe më pak i respekton rregullat.

Nëse ndiheni të pasigurt, nervozoheni gjatë ngasjes, dyshoni në aftësitë tuaja, vini re se vazhdimisht i bëni të njëjtat gabime, nuk është turp, kontaktoni autoshkollë, gjeni instruktor të mirë dhe ngisni disa orë shtesë. Besoni se do t'ju paguhet.

MBANI MEND:

**TË ULUR PAS TIMONIT NË AUTOMJET, MERRNI
PËRGJEGJËSI TË MADHE JO VETËM PËR VETEN
TUJ, POR EDHE PËR PJESËMARRËSIT E TJERË NË
KOMUNIKACION QË KANË QENË ME JU NË
RRUGË.**

KUSHTET PËR TË NGASUR AUTOMJETIN

Automjeti në komunikacionin rrugor mund të drejtohet në mënyrë të pavarur vetëm nga personi i cili ka patentë shoferi të vlefshme të lëshuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, patentë shoferi të huaj ose patentë shoferi ndërkombëtar, e cila përfshin kategorinë në të cilën automjeti ose bashkautomjeti i përket.

Shoferi i cili në patentë shofer ka kufizim të ngasjes së automjetit me marsh automatik në komunikacionin rrugor lejohet të ngas vetëm automjetin me marsh automatik.

Traktori në komunikacionin rrugor mund të drejtohet nga personi që ka patentë shoferi të vlefshme nga kategoritë "B", "BE", "C1", "C1E", "C", "CE", "D1", "D1E", "D" dhe "DE" dhe kategorinë nacionale "F".

Automjeti ose automjeti me fuqi motorike në komunikacionin rrugor nuk duhet të drejtohet nga shoferi, patentë shoferi i të cilit ka skaduar.

Shoferi është i detyruar të përdorë mjetet ndihmëse të regjistruara në patentë shofer gjatë ngasjes së automjetit ose automjetit me fuqi motorike.

Shoferi që është aq i lodhur ose i sëmurë ose ndodhet në gjendje të tillë psikike sa është i paaftë për të ngasur në mënyrë të sigurt, si dhe shoferi nën ndikimin e ilaçeve në të cilat është shënuar se nuk duhet të përdoren para ose gjatë ngasjes, nuk mund të ngasë automjet në komunikacionin rrugor.

Shoferi nuk duhet të ngasë automjetin në komunikacionin rrugor dhe as të fillojë të ngasë nëse është nën ndikimin e drogave dehëse ose substancave psikotrope.

Personi do të konsiderohet të jetë nën ndikimin e drogave dehëse ose substancave psikotrope, nëse analiza e gjakut ose gjakut dhe urinës ose me metodë tjetër matëse do të përcaktojë praninë e këtyre mjeteve në organizmin e tij.

Shoferi nuk duhet të ngasë automjet në komunikacionin rrugor, as të fillojë të ngasë nëse është nën ndikimin e alkoolit.

Personi për të cilin analiza e gjakut ose gjakut dhe urinës ose metoda tjetër për matjen e sasisë së alkoolit në organizëm, do të përcaktojë se përmbajtja e alkoolit në gjak është më shumë se 0.50 g / kg do të konsiderohet të jetë nën ndikimin e alkoolit ose nëse prania e alkoolit në organizëm përcaktohet me mjete të përshtatshme ose me aparate për matjen e alkoolit (njehsor alkooli, etj.), që korrespondon me sasi të mëdha se 0.50 g / kg ose në të cilat, pavarësisht nga përmbajtja e alkoolit në gjak, me kontrollim profesional do të konstatohet se tregon shenja të çrregullimit të alkoolit.

Nuk duhet të ngasë automjetin, përkatësisht të fillojë ngasjen e automjetit, nëse ka alkool në organizëm më shumë se 0,09 g / kg (në praktikë kjo do të thotë zero tolerancë për alkoolin) ose nëse tregon shenja të çrregullimit të alkoolit:

- shoferi fillestar,
- shoferi i automjetit nga kategoritë: "BE", "C1", "C1E", "C", "CE", "D1", "D1E", "D" dhe "DE" - gjatë ngasjes së automjetit të asaj kategorie,
- shoferi i mjetit me të cilin kryhet transporti publik derisa me atë mjet kryen transport publik,
- shoferi i automjetit për të cilin ngasja e automjetit është profesioni themelor - derisa ngasja e automjetit duke i kryer aktivitetet e këtij profesioni,
- shoferi instruktor dhe kandidati për shofer gjatë trajnimit në ngasjen praktike të automjetit,
- kryetari dhe anëtarët e komisionit të provimit gjatë zhvillimit të pjesës praktike të provimit të ngasjes së automjetit dhe
- shoferi që nuk ka patentë shofer.

RESPEKTOJI kufizimet për shofer fillestar

"Shofer fillestar" është çdo shofer i automjetit për periudhë dyvjeçare pasi të ketë shënuar datën e lëshimit të kategorisë në patentë shofer, pavarësisht nëse e ka marrë lejen në Republikën e Maqedonisë së Veriut apo jashtë saj dhe nëse ka patentë shoferi për kategori tjetër.

Shoferi fillestar që ka patentë shoferi të kategorive "A1", "A2", "A", "B", "C1", "C", "C1E" dhe "CE", nuk duhet të ngasë automjetin me shpejtësi më të lartë se 60 km / orë në rrugë publike, përkatësisht me shpejtësi më të madhe se 80 km / orë në rrugë, të destinuara ekskluzivisht për komunikacion të automjeteve, përkatësisht me shpejtësi më të madhe se 100 km / orë në autostradë dhe me biçikletë me motor më shumë se 40 km / orë, dhe as nuk mund të tërheqë rimorkio me automjet ose të kryejë transport të organizuar të fëmijëve, brenda dy viteve nga dita e lëshimit të patentë shoferit. (Tabela 2)





Shoferi fillestar që ka patentë shoferi nga kategoritë "A1", "A2", "A", "B", "C1" dhe "C"	
	në rrugë publike
	në rrugë të destinuar ekskluzivisht për komunikacionin e automjeteve
	autostradë
	biçikleta me motor

Tabela 2

Shoferi fillestar nga kategoritë "AM", "A1", "A2", "A" dhe "B" nuk duhet të ngasë mjet në komunikacionin rrugor nga ora 23:00 deri në orën 05:00, përveç shoferit fillestar nga kategoria "B" nëse ka shofer me të në automjet në sediljen e përparme, nga kategoria përkatëse që është më i vjetër se 25 vjeç dhe për të cilin nuk ka ndalim të sanksionit kundërvajtës për ngasjen e automjetit. (Foto. 2)



Foto. 2

Shoferi fillestar që ka patentë shoferi të kategorisë "A" nuk duhet të ngasë mjet me fuqi motorike më të madhe se 40 kilovat, dhe nëse ka patentë shoferi të kategorisë "A2", nuk duhet të ngasë mjet, fuqia motorike e të cilit është më e madhe se 25 kilovat.

Shoferi fillestar që ka patentë shoferi të kategorisë "B" nuk duhet të ngasë automjet me fuqi motorike më të madhe se 77 kilovat. (Foto. 3)



Foto. 3

RESPEKTOJI rregullat e komunikacionit rrugor dhe dispozitat themelore

Pjesëmarrësit në komunikacion janë të detyruar të veprojnë:

- Në përputhje me rregullat e komunikacionit, me sinjalizimin e komunikacionit të vendosur në rrugë, si dhe me shenjat e komunikacionit dhe urdhrat e dhëna nga nëpunësit policorë.
- Në përputhje me sinjalizimin e komunikacionit të vendosur në rrugë dhe kur ato devijojnë nga rregullat e komunikacionit.
- Sipas semaforit dhe kur ajo shenjë dallon nga rregulli i përparësisë së kalimit i shprehur në të njëjtin vend me shenjë tjetër të komunikacionit.
- Në përputhje me rregullat e komunikacionit, në udhëkryq të rregulluar nga semaforët, në lidhje me të drejtën e ndërsjellë të përparësisë së kalimit të automjeteve.
- Sipas kërkesave të dhëna me ndihmën e shenjave ose sipas urdhrave të dhëna nga nëpunësit policorë dhe personat zyrtarë të uniformuar dhe kur ato devijojnë nga rregullat e përcaktuara të komunikacionit ose nga kuptimi i sinjalizimit të komunikacionit të vendosur në rrugë.

Shoferi është i detyruar t'u kushtojë vëmendje këmbësorëve që ndodhen në rrugë ose që kanë filluar të ecin në rrugë. Kur afrohet në vendkalim të shënuar për këmbësorë, shoferi është i detyruar të ngasë automjetin dhe të ngasë me shpejtësi të tillë që lejon në rast të nevojës të ndalojë automjetin përpara vendkalimit për këmbësorë.

Në pjesën e rrugës ku lëvizin fëmijët ose vendosen shenja të komunikacionit që fëmijët të marrin pjesë në komunikacion, shoferi është i detyruar të ngasë me kujdes të veçantë dhe me shpejtësi të tillë që do t'i mundësojë atij të ndalojë automjetin në rast nevoje.

Shoferi i automjetit që lëviz pranë mjetit të transportit publik të pasagjerëve ose pranë autobusit me të cilin transporton për nevojat e tij, i ndaluar në stacion, është i detyruar të lëvizë me shpejtësi të zvogëluar, në mënyrë që nuk i rrezikon personat që hyjnë ose dalin nga mjeti.

Shoferi është i detyruar të ndalojë automjetin e tij prapa mjeteve për transport publik të pasagjerëve, kur personat që hyjnë në ato mjete, përkatësisht duke dalë nga ato mjete, duhet të kalojnë në korsinë e komunikacionit dhe shtegun e biçikletave ose korsinë në të cilën lëviz mjeti.

Shoferi i automjetit që lëviz prapa mjetit me të cilin kryhet transporti i organizuar i fëmijëve, si dhe shoferi i automjetit që takon atë mjet në rrugë me dy korsi komunikacioni, është i detyruar të ndalet kur mjeti me të cilin fëmijët transportohen në mënyrë të organizuar ndalet në rrugë, ndërsa fëmijët hyjnë ose dalin nga mjeti.

Mjeti me të cilin kryhet transporti i organizuar i fëmijëve, detyrimisht duhet të plotësojë kushte të veçanta dhe të shënohet me shenjë të veçantë, ndërsa gjatë hyrjes dhe daljes së fëmijëve nga mjeti, shoferi është i detyruar t'i ndezë të gjithë treguesit e drejtimit të mjetit.

Gjatë ngasjes në vendbanim, shoferi është i detyruar të lejojë që të përfshihen në komunikacion mjeti i qytetit për transportin publik të pasagjerëve ose mjeti i shënuar posaçërisht me të cilin kryhet transporti i organizuar i fëmijëve, kur ato mjete dalin nga stacioni që ndodhet jashtë rrugës, përkatësisht nga zgjerimi i korsisë që shërben si stacion. Shoferi i këtyre mjeteve është i detyruar para fillimit të përfshirjes së serishme në komunikacion, me ndihmën e treguesit të drejtimit, të njoftojë qëllimin e tij për t'u përfshirë në komunikacion dhe për ta kryer atë përfshirje në mënyrën që nuk rrezikojnë pjesëmarrësit tjerë në komunikacion.

Shoferi i mjetit me rripa të sigurimit të instaluar dhe personat e transportuar me atë mjet, janë të detyruar të lidhen me ato rripa në mënyrën e përcaktuar nga prodhuesi i mjetit, derisa mjeti lëviz në komunikacionin rrugor. Ky obligim nuk vlen për:

-furnizuesin e mallrave në qarkullim, në vendin e dërgimit dhe

-shoferët kur lëvizin me automjet me shpejtësinë e ecjes së njeriut, kur lëvizin prapa dhe në parkingje.

Shoferi i automjetit, gjatë ngasjes së automjetit, nuk duhet të përdorë celular ose pajisje të tjera në mënyrën që të zvogëlojë aftësinë për të reaguar dhe ngasjes së automjetit në mënyrë të sigurt. Me përjashtim, celulari dhe pajisjet e tjera mund të përdoren gjatë ngasjes së automjetit, nëse përdoret pajisja e cila mundëson përdorimin e tyre pa përdorimin e duarve.

RESPEKTOJI veprimet me automjetin në komunikacion



Shoferi që synon të kryejë ndonjë veprim në rrugë me automjetin (lëvizjen e automjetit në të djathtë ose në të majtë, ndërrimin e korsisë, parakalimin, kalimin, ndalimin, kthimin djathtas ose majtas, kthimin gjysmërrethor, ngasjen prapa, etj.), mund të fillojë veprimin e tillë vetëm nëse ka qenë më parë i bindur se mund ta bëjë këtë pa rrezik për pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion ose për pronën, duke marrë parasysh pozicionin e automjetit dhe drejtimin dhe shpejtësinë e lëvizjes së automjetit.

Para kryerjes së veprimeve me automjet, shoferi i automjetit është i detyruar t'i informojë qartë dhe në kohë pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion për qëllimin e tij, duke dhënë shenjë me ndihmën e treguesve të drejtimit ose nëse nuk ekzistojnë – me shenjë përkatëse me dorë. Nëse shoferi e jep shenjën me ndihmën e treguesit të drejtimit, ai është i detyruar ta japë për tërë kohën e kryerjes së veprimit me automjetin, ndërsa pas veprimit të kryer të ndalet. Me përjashtim, shoferi është i detyruar pas parakalimit të kryer të automjetit tjetër të japë shenjë se synon të kthehet në korsinë në të cilën kishte lëvizur para se të parakalonte.

Shoferi i cili me automjet përfshihet në komunikacion në rrugë publike ose zonë tjetër të komunikacionit (dalja e automjetit nga garazhi, oborri, parkingu, vendqëndrimi, stacioni ose nga zona ku nuk ka komunikacion), është i detyruar t'i lëshojë të gjitha automjetet dhe këmbësorët që lëvizin në rrugë, përkatësisht në zonën e komunikacionit në të cilën përfshihet.

Shoferi i mjetit transportues dhe autobusit, kur përfshihet në komunikacion nga garazhi, oborri ose zona tjetër e ngjashme, nëse dukja e tij është e fshehur nga automjeti tjetër, objekti ose sendi ose nëse dukshmëria e tij zvogëlohet, është i detyruar në vendin ku do të përfshihet të vendosë person për të ndihmuar mjetin të dalë i sigurt nga rruga.

Shoferi i cili përfshihet në komunikacionin rrugor në rrugë të papastër, vend ndërtimi ose zonë tjetër të komunikacionit është i detyruar të ndalojë automjetin dhe të heqë rërën dhe mbeturinat e tij nga gomat e automjetit.

Drejtuuesi i biçikletës, biçikletës me motor ndihmës, mopedit, motoçikletës, triçikletës, katërçikletës së lehtë dhe katërçikletës, përkatësisht drejtuesi i mjetit mbrehës që përfshihet në komunikacion në rastet e përmendura është i detyruar të shtyjë mjetin, përkatësisht të drejtojë kafshën e lidhur.

RESPEKTOJI rregullat dhe lëvizjen e automjeteve në rrugë

Shoferi është i detyruar të përdorë vetëm rrugën, përkatësisht rrugën ose korsinë e komunikacionit, përkatësisht rrugën e destinuar për komunikacion të llojit të automjeteve të cilave i përket automjeti i tij, përveç në rast rreziku. (Foto. 4)




Fotografia 4

Automjeti detyrimisht lëvizë në anën e djathtë të rrugës në drejtim të lëvizjes.

Shoferi është i detyruar ta mbajë automjetin në lëvizje sa më afër skajit të djathtë të rrugës dhe në distancë të tillë prej tij që duke pasur parasysh shpejtësinë e lëvizjes së automjetit, kushtet e komunikacionit dhe gjendjen dhe vetitë e rrugës nuk do t'i rrezikojë pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion dhe të mos rrezikoj veten.

Me përjashtim, shoferi i automjetit që lëviz me shpejtësi më të ulët se shpejtësia e lëvizjes së mjetit në binarë, në vend ku binarët janë vënë në skaj të rrugës, është i detyruar të lëvizë në distancë të mjaftueshme nga binarët, në mënyrë që të mos pengohet lëvizja e mjeteve në binarë dhe pjesëmarrësve të tjerë në komunikacion.

Në rrugë publike në vendbanim, me rrugë në të cilën për qarkullimin e automjeteve në të njëjtin drejtim ka të paktën dy korsi të komunikacionit të shënuar për lëvizjen e automjetit, shoferi mund të përdorë korsinë e komunikacionit që nuk ndodhet pranë skajit të djathtë të rrugës, nëse kështu nuk pengon automjetet e tjera që lëvizin prapa automjetit të tij. (Foto. 5)




Fotografia 5

Kjo dispozitë nuk vlen për shoferin e:

- ➔ mjetit transportues, masa maksimale e lejuar e të cilit është më e madhe se 3500 kg; (Foto. 5)
- ➔ shoferi i mjetit që në rrugë të sheshtë nuk mund të zhvillojë shpejtësi prej më shumë se 40 km / orë dhe
- ➔ shoferi i mjetit i cili nuk konsiderohet mjet motorik, përveç në pjesën e rrugës para udhëkryqit ose në vend tjetër ku mjeti kthen majtas.


Në rrugë publike me dy ose më shumë korsi të komunikacionit të shënuar për lëvizjen e automjetit në të njëjtin drejtim, automjetet detyrimisht lëvizin në mes të korsisë së shënuar të komunikacionit në të cilin lëvizin.

Në rrugë publike me rrugë për qarkullimin e automjeteve në të dyja drejtimet, në të cilën ka të paktën katër korsi komunikacioni, shoferi nuk duhet me automjetin të kalojë në korsinë e destinuar për komunikacionin e automjeteve nga drejtimi i kundërt. (Foto. 6)




Fotografia 6

Në rrugë publike me qarkullim të automjeteve në të dyja drejtimet në të cilën ka tre korsi komunikacioni, shoferi nuk duhet të lëvizë automjetin përgjatë korsisë që ndodhet në skajin e majtë të rrugës në drejtim të lëvizjes së automjetit. (Foto. 7)




Fotografia 7

Në rrugë publike ku korsitë janë të ndara fizikisht nga njëra-tjetra, shoferi nuk duhet të lëvizë me automjetin në korsinë e destinuar për qarkullimin e automjeteve nga drejtimi i kundërt. (Foto. 8)



Fotografia 8

Në rrugë publike për qarkullim të automjeteve në një drejtim, shoferi nuk duhet të lëvizë me automjetin në drejtimin e ndaluar. (Foto. 9)



Fotografia 9

Në rrugë ku ka të paktën dy korsi të destinuara për lëvizjen e automjeteve në të njëjtin drejtim dhe në të cilën ka kolona automjeteve, shoferi nuk duhet të kalojë me automjetin nga njëra korsi në korsinë tjetrën (lëvizja zigzag).


Shoferi mund ta lëshojë korsinë e komunikacionit në të cilën ndodhet, vetëm për të kthyer majtas ose djathtas ose për të ndaluar ose parkuar automjetin. (Foto. 10)



Fotografia 10

Shoferi i cili synon të lëvizë me automjetin prapa, mund ta kryejë atë veprim vetëm në një pjesë të shkurtër të rrugës, nëse nuk rrezikon ose pengon pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion.

Kur shoferi lëviz me automjetin prapa, është i detyruar t'i nderëzë treguesit e drejtimit, t'i lëshojë të gjitha automjetet që lëvizin pas tij dhe të lëvizë në anë të rrugës në të cilën po ngiste deri atëherë me ngasjen përpara. (Foto. 11)



Fotografia 11

Shoferi nuk duhet të lëvizë prapa me automjetin, as të ngasë në qafë mali, kthesa, udhëkryqe dhe të kalojë një rrugë që kalon mbi vijën hekurudhore të nivelit, nëse dukshmëria është e pamjaftueshme ose rruga është në kushte të dukshmërisë së zvogëluar.

RESPEKTOJE kufizimin dhe rregullimin e shpejtësisë së lëvizjes

Shoferi është i detyruar të rregullojë shpejtësinë e automjetit me vetitë dhe kushtet e rrugës, dukshmërinë, kushtet e motit, gjendjen dhe ngarkesën e automjetit, dendësinë e komunikacionit dhe kushtet e tjera të komunikacionit, në mënyrë që të mund ta ndalojë automjetin në kohë para çdo pengese e cila në kushtet e dhëna mund ta parashikojë.

Shoferi nuk duhet të zvogëlojë shpejtësinë e lëvizjes së automjetit në masën që automjeti i tij do të jetë pengesë për rrjedhën normale të komunikacionit.

Shoferi, automjeti i të cilit për shkak të gjendjes teknike, gjendjes së ngarkesës ose arsyeve të tjera nuk është në gjendje të ndjekë shpejtësinë e përcaktuar të lëvizjes së automjeteve në rrugë dhe kështu e pengon rrjedhën normale të komunikacionit, dhe për shkak të mungesës së kushteve për parakalim të sigurt krijohet kolonë automjetesh, është i detyruar të ngasë në anën e djathtë të rrugës. Nëse edhe kjo nuk mjafton, ta ndalojë automjetin në vendin e parë të përshtatshëm jashtë rrugës për t'i lëshuar automjetet që lëvizin pas tij. Shoferi i cili lëviz me shpejtësi më të ulët se gjysma e shpejtësisë maksimale të lejuar, të përcaktuar nga lloji i rrugës ose një pjesë të rrugës, është i detyruar t'i nderzë të gjithë treguesit e drejtimit ose dritën e verdhë rrotulluese.

Shoferi nuk duhet të ndryshojë mënyrën e ngasjes së automjetit duke zvogëluar ose rritur shpejtësinë e lëvizjes dhe të fillojë automjetin duke arritur kufirin e sipërm mbi numrin e lejuar të rrotullimeve të motorit, përkatësisht rrëshqitjen e gomave, përveç në rast të rrezikut të pashmangshëm.

Shoferi që synon të zvogëlojë ndjeshëm shpejtësinë e lëvizjes së automjetit, është i detyruar ta bëjë këtë, përveç në rast të rrezikut të afërt, në mënyrën që nuk do ta rrezikojë atë ose në masën më të madhe t'i pengojë shoferët e tjerë që lëvizin pas tij, si dhe t'i paralajmërojë ata shoferë për qëllimin e tij duke nderzur dritën e frenimit ose duke dhënë shenjë të përshtatshme me dorën e tij.

Në rrugë publike në vendbanim, shoferi nuk duhet të lëvizë me automjetin me shpejtësi më të madhe se 50 km / h, përkatësisht me shpejtësi më të madhe se shpejtësia e lejuar nga shenja e përcaktuar e komunikacionit për të gjithë vendbanimin ose për një pjesë të caktuar të saj. Me përjashtim, në rrugë publike në vendbanim, elementët teknikë të komunikacionit të të cilit e bëjnë të mundur, me shenjë komunikacioni mund të lejojë lëvizjen me automjet edhe me shpejtësi më të madhe se 50 km / orë, por jo më të lartë se 70 km / orë.

Në rrugë publike jashtë vendbanimit, shoferi nuk duhet të lëvizë automjetin me shpejtësi më të madhe se: (Tabela 3)

130 km / orë	në autostradë;
110 km / orë	në rrugë të rezervuar për komunikacion të automjeteve dhe
90 km / orë	në rrugë të tjera.

Tabela 3

Në rrugën jashtë vendbanimit, shoferi nuk duhet të lëvizë automjetin me shpejtësi më të madhe se shpejtësia e përcaktuar nga shenja e komunikacionit të vendosur në rrugë.

Shpejtësia e lëvizjes së automjeteve në rrugë publike, në kushte normale të komunikacionit, nuk mund të kufizohet nga shenja e komunikacionit nën 40 km / orë. Në rast se kushtet e rrugës ose kushtet e komunikacionit e kërkojnë atë, shpejtësia e lëvizjes së automjeteve në rrugë mund të kufizohet me shenjën e komunikacionit edhe nën 40 km / orë.

Në rrugët publike kufizohet shpejtësia e lëvizjes së kategorive të mëposhtme të automjeteve në: (Tabela 4)

80 km / orë	për autobusët dhe autobusët me rimorkio të lehtë, për mjetet transportuese, masa maksimale e lejuar e të cilave nuk është më e madhe se 7.500 kg, për mjetet që tërheqin kamp-rimorkio dhe për mjetet e pasagjerëve që tërheqin rimorkio të lehtë;
70 km / orë	për autobusët kur kryhet transporti i organizuar i fëmijëve, për autobusët me nyje që nuk kanë vende të përcaktuara për të qëndruar, për mjetet transportuese, masa maksimale e lejuar e të cilave është më e madhe se 7.500 kg dhe për mjetet transportuese që tërheqin rimorkio;
60 km / orë	përkatësisht 80% e shpejtësisë maksimale të lejuar të përcaktuar nga lloji i rrugës, përkatësisht të përcaktuar nga shenjat e komunikacionit të vendosura në rrugë, por jo më shumë se 70 km / orë - për mjetet që transportojnë mallra të rrezikshme, përkatësisht jo më shumë se 60 km / orë - për mjetet që transportojnë materie helmuese;
50 km / orë	për autobusët dhe autobusët me nyje për transportin e personave në komunikacionin e qytetit të cilët përveç sediljeve të instaluar, kanë edhe vende të caktuara për qëndrim, për mjetet transportuese që kryejnë transport në grup të personave në rutinë e transportit dhe për mjetet me zinxhirët e gomave;
40 km / orë	për mjetin që tërheq mjet tjetër me defekt;
30 km / orë	për traktorët;
25 km / orë	për traktorët që tërheqin rimorkio që transportojnë persona; si dhe biçikletat, biçikletat me motor ndihmës dhe mopedët kur lëvizin në shteg biçikletash dhe korsi dhe
20 km / orë	trenin turistik.

Tabela 4

Me përjashtim, në autostradë kufizohet shpejtësia e lëvizjes së kategorive të mëposhtme të mjeteve në: (Tabela 5)

100 km / orë	për autobusët, masa maksimale e lejuar e të cilëve nuk është më e madhe se 3,500 kg;
100 km / orë	për mjetet transportuese, masa maksimale e lejuar e të cilave nuk është më e madhe se 3,500 kg;
90 km / orë	për mjetet transportuese, masa maksimale e lejuar e të cilave varion nga 3,500 kg deri në 7,500 kg;
80 km / orë	për mjetet transportuese, masa maksimale e lejuar e të cilave është më e madhe se 7,500 kg dhe
80 km / orë	për autobusët kur kryhet transporti i organizuar i fëmijëve.


(Tabela 5)

Kur ngasin automjete, shoferët janë të detyruar t'i përmbahen shpejtësisë së përcaktuar dhe në rrugë ku shpejtësia më e madhe lejohet me ligj ose me shenjë të komunikacionit.


Automjetet dhe rimorkiot të regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përveç automjeteve të Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe policisë, detyrimisht duhet të kenë shenjë të vendosur në gjysmën e majtë të anës së pasme, në formën e rrethit të bardhë, të rrethuar me skaj të kuq në të cilën është shkruar me të zezë numri që e tregon shpejtësinë maksimale të lejuar të atyre automjeteve.

RESPEKTOJI rregullat e kthimit

Shoferi i automjetit që kthen djathtas, është i detyruar të bëjë kthesën duke lëvizur përgjatë kosisë së fundit të komunikacionit që shtrihet përgjatë skajit të djathtë të rrugës, përveç nëse përcaktohet ndryshe nga shenja e komunikacionit. (Foto. 12 dhe Foto. 13)




Fotografia 12



Fotografia 13

Shoferi i automjetit që kthen djathtas, është i detyruar të lëshojë mjetin që lëviz në anën e tij të djathtë përgjatë korsisë së komunikacionit të destinuar për mjetet që kryejnë transport publik të pasagjerëve. (Foto. 14 dhe Foto. 15)



Fotografia 14





Fotografia 15

Shoferi i automjetit që kthen majtas është i detyruar të bëjë kthesën duke lëvizur përgjatë korsisë së majtë që shtrihet përgjatë vijës qendrore dhe përgjatë harkut imagjinar ose të shënuar që i lidh të dy linjat qendrore në rrugët anësore, përkatësisht përgjatë korsisë së komunikacionit që shtrihet përgjatë skajit të majtë të rrugës me komunikacion në një drejtim, përveç nëse përcaktohet ndryshe nga shenja e komunikacionit në rrugë. (Foto. 16)



Fotografia 16

Shoferi i automjetit nuk duhet të bëjë kthesë gjysmërrethore në qafë mali, kthesë, aks rrugor mbi vijën hekurudhore në nivel, në urë, mbikalim, nënkalim, si dhe në kushte të dukshmërisë së zvogëluar, në vendet e tjera ku dukshmëria e rrugës është e pamjaftueshme ose në pjesë të rrugës ku nuk ka hapësirë të mjaftueshme për kthesë gjysmërrethore. (Foto. 17, 18 dhe 19)



Fotografia 17



Fotografia 18



Fotografia 19


RESPEKTOJI rregullat se kush ka përparësi kalimi

Në udhëkryq të rrugëve me të njëjtën rëndësi ose në pritje të automjetit tjetër, shoferi është i detyruar të lëshojë automjetin që vjen nga ana e tij e djathtë. (Foto. 20)



Fotografia 20

Shoferi i automjetit që kthen majtas në udhëkryq është i detyruar të lëshojë automjetin që vjen nga drejtimi i kundërt, në udhëkryq e mban drejtimin e lëvizjes së tij ose kthen djathtas, përveç nëse përcaktohet ndryshe nga shenja e vendosur e komunikacionit (Foto. 21). Me përjashtim, mjete që lëviz në binarë ka përparësi të kalimit në udhëkryq ose në pritje të automjetit tjetër, pavarësisht nga cila anë vjen, përveç nëse përcaktohet ndryshe nga shenja e vendosur e komunikacionit.



Fotografia 21

Shoferi i cili hyn në rrugë me automjet që me shenjë të komunikacionit është e shënuar si rrugë me përparësi kalimi, është i detyruar t'i lëshojë të gjitha automjetet që lëvizin në atë rrugë. (Foto. 22)



Fotografia 22

Shoferi është i detyruar t'i lëshojë të gjitha automjetet që lëvizin në rrugën në të cilën hyn dhe kur nuk është e shënuar me shenjë të komunikacionit si rrugë me përparësi kalimi, nëse automjeti hyn nga rruga tokësore, rruga makadame në rrugë me trotuar ose nëse në rrugë hyn nga zona që nuk është e destinuar për komunikacionin dinamik.

Shoferi që kalon shtegun ose korsinë e biçikletave gjatë kthimit të automjetit, është i detyruar t'i lëshojë biçikletat, biçikletat me motor ndihmës, mopedët, triçikletat dhe katërçikletat e lehta që lëvizin përgjatë shtegut ose korsisë së biçikletave. (Foto. 23)



Fotografia 23

RESPEKTOJI rregullat e komunikacionit në udhëkryq

Shoferi i cili afrohet në udhëkryq është i detyruar të ngasë me kujdes të shtuar që u përshtatet kushteve të komunikacionit në udhëkryq.

Shoferi i cili afrohet në udhëkryq është i detyruar të ngasë me shpejtësi që mundëson të ndalojë dhe t'i lëshojë automjetet që kanë përparësi kalimi në udhëkryq.

Shoferi është i detyruar të jetë në distancë të mjaftueshme para udhëkryqit me automjetin për të marrë pozicion në atë korsi komunikacioni nëpër të cilën detyrimisht duhet të kalojë nëpër udhëkryq.

Në udhëkryq dhe në vendet e tjera ku komunikacioni rregullohet posaçërisht me pajisje për dhënien e shenjave të komunikacionit me dritë, shenjat e komunikacionit me dritë për pjesëmarrësit në komunikacion kanë këto kuptime: (Foto. 24)

- drita e kuqe - ndalim kalimi,
- drita e gjelbër - kalim i lirë dhe
- drita e verdhë - ndalim kalimi, përveç automjeteve që në momentin kur do të shfaqet drita e verdhë janë në distancë të tillë nga shenja e dritës që nuk mund të ndalen në mënyrë të sigurt pa mos e kaluar atë shenjë; për pjesëmarrësit e tjerë - ndalim kalimi, përveç atyre këmbësorëve që tashmë kanë filluar të kalojnë rrugën.



Fotografia 24

Drita e verdhë, e ndezur njëkohësisht me dritën e kuqe, shërben si paralajmërim për pjesëmarrësit në komunikacion për ndërprerjen e afërt të ndalimit të kalimit dhe për shfaqjen e dritës së gjelbër. (Foto. 25)



Fotografia 25

Drita e verdhë vezulluese i detyron të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion të lëvizin me kujdes të shtuar. (Foto. 26)



Fotografia 26

Drita e gjelbër vezulluese shërben për t'i paralajmëruar pjesëmarrësit në komunikacion për ndërprerjen e afërt të kalimit të lirë dhe për shfaqjen e dritës së verdhë, përkatësisht dritës së kuqe. (Foto. 27)



Fotografia 27

Nëse pajisjes për dhënien e shenjave të komunikacionit me dritë për rregullimin e komunikacionit në udhëkryq i është dhënë një ose më shumë shenja shtesë në formën e shigjetës me dritë të gjelbër, shoferi mund të kalojë shenjën e dritës me automjetin dhe të shkojë në drejtimin e shënuar nga shigjeta e dritës së gjelbër dhe për kohën kur drita e kuqe ose drita e verdhë është e ndezur. Pastaj nuk duhet të pengojë komunikacionin e automjeteve që lëvizin në rrugën ku hyn dhe detyrimisht duhet t'i lëshojë këmbësorët që kalojnë rrugën. (Foto. 28)




Fotografia 28

Nëse drita e gjelbër në pajisjen për dhënien e shenjave të komunikacionit me dritë është në formën e shigjetës, shoferi mund të lëvizë automjetin vetëm në drejtimin e treguar nga shigjeta. (Foto. 29)



Fotografia 29

Shoferi i cili lejohet të hyjë në udhëkryq me shenjën e komunikacionit me dritë, nuk duhet të hyjë në udhëkryq me automjetin nëse dendësia e komunikacionit është e tillë që automjeti padyshim që duhet të ndalet në udhëkryq dhe kështu gjatë zbatimit të shenjës së dritës, ta pengojë ose pamundësojë qarkullimin e automjeteve që vijnë nga rrugët anësore. (Foto. 30)



Fotografia 30

Shoferi i cili ka hyrë në udhëkryq ku komunikacioni rregullohet nga pajisjet për dhënien e shenjave të komunikacionit me dritë mund ta lëshojë udhëkryqin pa pritur që komunikacioni të jetë me shenjë drite të hapur në drejtimin në të cilin synon të vazhdojë lëvizjen, me kusht që t'i lëshojë të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion që lëvizin në drejtimin në të cilin komunikacioni është i hapur.

RESPEKTOJI rregullat e komunikacionit në udhëkryq me rrethrotullim në komunikacion


Komunikacioni në udhëkryq me rrethrotullim rregullohet nga sinjalizimi i komunikacionit. Shoferi i cili lëviz në udhëkryq me rrethrotullim ka përparësi ndaj shoferëve që janë të përfshirë në udhëkryq. (Foto. 31)



Fotografia 31


Personat juridikë kompetentë për mirëmbajtjen e rrugëve janë të detyruar të instalojnë dhe mirëmbajnë sinjalizimin e komunikacionit në udhëkryqin me rrethrotullim.

Shoferi që lëviz në udhëkryq me rrethrotullim ku rruga ka dy ose më shumë kors, është i detyruar të qëndrojë në korsinë e brendshme të komunikacionit në mënyrë që të mundësojë që shoferët e tjerë të hyjnë në udhëkryq, përveç nëse synon të lëshojë udhëkryqin në dalje më të afërt ose për shkak të dendësisë së komunikacionit nuk është në gjendje të qëndrojë në mënyrë të sigurt. (Foto. 32)




Fotografia 32

Kur përfshiheni në komunikacion në udhëkryq me rrethrotullim ku ka dy korsi, automjeti në korsinë e djathtë përfshihet me korsinë e jashtme, ndërsa automjeti që lëviz në korsinë e majtë përfshihet në korsinë e brendshme. (Foto. 33)



Fotografia 33

Para se ta lëshojë udhëkryqin, shoferi është i detyruar të qëndrojë në korsinë e jashtme të komunikacionit, përveç në dalje ku sinjalizimi i komunikacionit përcakton se lejohet të kthehet djathtas nga korsa e brendshme e komunikacionit. (Foto. 34)




Fotografia 34

Në dalje nga udhëkryqi me rrethrotullim ku lejohet të kthehet djathtas dhe nga korsa e brendshme e komunikacionit, korsa e jashtme e komunikacionit është destinuar ekskluzivisht për të kthyer djathtas. Personat juridikë kompetentë për mirëmbajtjen e rrugëve janë të detyruar të shënojnë siç duhet korsinë e jashtme të komunikacionit.


RESPEKTOJI rregullat e kalimit

Kur kalon, shoferi është i detyruar të lë distancë të mjaftueshme nga ana e tij e majtë midis automjetit të tij dhe automjetit që po kalon, ndërsa nëse është e nevojshme të lëvizë automjetin e tij në skajin e djathtë të rrugës. (Foto. 35)



Fotografia 35

Nëse shoferi, për shkak të pengesës në rrugë ose për shkak të pjesëmarrësve të tjerë në komunikacion, nuk mund të veprojë në përputhje me dispozitën e përmendur, është i detyruar të ngadalësojë lëvizjen e automjetit të tij dhe nëse është e nevojshme ta ndalojë atë në mënyrë që të lëshojë automjetin nga drejtimi i kundërt. (Foto. 36)



Fotografia 36

Kur automjetet vijnë nga drejtime të kundërta në udhëkryq dhe kthejnë majtas, shoferi e kalon automjetin në drejtim të kundërt duke e kaluar në anën e tij të djathtë. (Foto. 37)




Fotografia 37

Nëse për shkak të gjerësisë së pamjaftueshme të rrugës, ose për shkak të pengesës tjetër në rrugë, kalimi është i pamundur, shoferi i cili, duke pasur parasysh karakteristikat e rrugës dhe rrethanat e komunikacionit, e ka më të lehtë për ta bërë këtë, është i detyruar të ndalet së pari dhe nëse është e nevojshme me lëvizjen prapa ose ndryshe për të lëvizur automjetin e tij dhe për të marrë pozicion të tillë në rrugën që mundëson kalimin. (Foto. 38)




Fotografia 38

Në pjesën e rrugës publike me pjerrësi të madhe (mal, etj.) ku kalimi i automjeteve është i pamundur ose shumë i vështirë, shoferi i automjetit që lëviz nëpër pjerrësi, është i detyruar të ndalojë automjetin e tij në vend të përshtatshëm, nëse vëren se pas pjerrësisë nga poshtë i vjen automjet tjetër. (Foto. 39)



Fotografia 39


Me përjashtim, shoferi i cili lëviz nëpër pjerrësi, është i detyruar të ndalojë automjetin e tij, nëse ka vend të përshtatshëm ndalimi para tij që mundëson kalimin e sigurt dhe nëse nuk e bën këtë, kalimi do të kërkonte lëvizjen prapa të njërit prej automjeteve. (Foto. 40)



Fotografia 40


Në rrugë publike me pjerrësi të madhe, kur një nga mjetet që kalojnë detyrimisht duhet të lëvizë prapa, do të lëvizë prapa (Foto. 41, Foto. 42 dhe Foto. 43):

1. Çdo mjet që ka hasur mjet që tërheq rimorkio,




Fotografia 41

2. Mjeti transportues që u takua me autobus, (Foto. 42)



Fotografia 42

3. Mjeti i lehtë që takohet me mjet të kategorisë më të lartë (Foto. 43) dhe




Fotografia 43

4. Automjeti që lëviz nëpër pjerrësinë - nëse kalojnë automjetet e së njëjtës kategori, përveç nëse, duke pasur parasysh kushtet dhe pozicionin e automjeteve në rrugë, është më lehtë që këtë ta bëjë shoferi i automjetit që lëviz nëpër pjerrësinë.

RESPEKTOJI rregullat e parakalimit dhe kalimit

Parakalim dhe kalim, shoferi mund të bëjë vetëm nëse kjo nuk e pengon lëvizjen normale të automjeteve që vijnë nga drejtimi i kundërt dhe nëse ka hapësirë të mjaftueshme në rrugë për kryerjen e sigurt të atyre veprimeve. (Foto. 44)




Fotografia 44

Shoferi nuk duhet të parakalojë dhe të kalojë rrugën, kur kështu, duke pasur parasysh karakteristikat e komunikacionit dhe rrethanat ekzistuese në rrugë dhe në komunikacion ose duke pasur parasysh karakteristikat teknike të automjetit që e nget, i rrezikon pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion. (Foto. 45)



Fotografia 45

Parakalimi dhe kalimi bëhet nga ana e majtë. (Foto. 46)




Fotografia 46

Parakalimi bëhet nga ana e djathtë, nëse automjeti në rrugë ka marrë pozicion të tillë dhe shoferi i tij jep shenjë të tillë nga i cili mund të konkludohet me siguri se automjeti po kthen në të majtë. (Foto. 47)




Fotografia 47

Mjeti që lëviz në binarë të vendosur në mes të rrugës nuk duhet të parakalohet në anën e majtë. Ai mjet mund të parakalohet në anën e djathtë, nëse ekziston korsi komunikacioni midis atij mjeti dhe skajit të djathtë të rrugës. (Foto. 48)




Fotografia 48

Nëse ka ishull këmbësorësh në mes të rrugës ose zonë të shënuar ose të caktuar ndryshe për parkimin e automjeteve, ose ndonjë objekt ose pajisje, automjetet duhet t'i kalojë detyrimisht në anën e djathtë. (Foto. 49)



Fotografia 49

Nëse sipërfaqet, objektet ose pajisjet janë të vendosura në mes të rrugës me komunikacion në një drejtim, ndërsa me shenjën e vendosur të komunikacionit nuk përcaktohet ndryshe, ata mund të kalohen në të dyja anët. (Foto. 50)



Fotografia 50

Shoferi të cilit i jepet shenja e parakalimit në anën e tij të majtë është i detyruar të lëvizë automjetin e tij në skajin e djathtë të rrugës.

Shoferi nuk duhet të rrisë shpejtësinë e lëvizjes së automjetit të tij gjatë kohës së parakalimit të automjetit tjetër.


Nëse për shkak të gjerësisë së pamjaftueshme të rrugës ose gjendjes së saj nuk është e mundur të parakalohet pa rrezikuar komunikacionin, shoferi i automjetit që lëviz më ngadalë se automjetet që lëvizin drejtpërdrejt pas tij, është i detyruar të lëvizë automjetin e tij sa më në të djathtë, nëse kjo nuk është e mjaftueshme, të ndalojë automjetin e tij në vend të përshtatshëm që do të mundësojë lëshimin e automjeteve që shpejtojnë.

Shoferi nuk duhet me automjet të fillojë parakalimin ose kalimin:
1. Kolonës së automjeteve. (Foto. 51)




Fotografia 51

2. Nëse shoferi që lëviz pas tij ka filluar parakalimin (Foto. 52)




Fotografia 52

3. Nëse shoferi që është para tij në të njëjtën korsi komunikacioni ka dhënë shenjë se synon të parakalojë ose të kalojë automjetin përpara automjetit të tij ose të kalojë pengesë tjetër në rrugë. (Foto. 53)



Fotografia 53

4. Nëse korsa e komunikacionit në të cilën është, me qëllim të bëjë parakalimin, nuk është e lirë në distancë të mjaftueshme, kështu që, duke marrë parasysh dallimin midis shpejtësisë së lëvizjes së automjetit të tij gjatë parakalimit dhe shpejtësisë së lëvizjes së automjeteve të pjesëmarrësve të tjerë në komunikacion e cila ka për qëllim t'i parakalojë, me parakalimin do të rrezikojë sigurinë në komunikacion ose do të pengojë komunikacionin nga drejtimi i kundërt. (Foto. 54)



Fotografia 54

5. Nëse, pas parakalimit ose kalimit të bërë, nuk mund të merrte përsëri pozicion në korsinë e komunikacionit në të cilin ka lëvizur para parakalimit ose kalimit, pa penguar ose rrezikuar pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion, përveç kur përdor korsinë e komunikacionit që është e ndaluar për parakalim ose kalim për qarkullimin e automjeteve nga drejtimi i kundërt (Foto. 54) dhe

6. Përgjatë korsisë së komunikacionit të destinuar për ndalimin e detyruar të automjeteve. (Foto. 55)




Fotografia 55

Shoferi i cili parakalon është i detyruar ta mbajë automjetin e tij në distancën e kërkuar nga mjeti që parakalon, në mënyrë që të mos pengojë ose rrezikojë komunikacionin. (Foto. 56)



Fotografia 56

Shoferi, pas parakalimit ose kalimit të një ose më shumë automjeteve, është i detyruar që me automjetin të marrë përsëri pozicionin në korsinë e komunikacionit në të cilin po lëvizte para fillimit të veprimit, me ç'rast atë do ta bëjë pa penguar ose rrezikuar pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion. (Foto. 57)



Fotografia 57

Në rrugë ku komunikacioni zhvillohet në dy drejtime, shoferi nuk duhet të parakalojë automjet tjetër në urë, në tunel, përpara majës së rrugës ose në kthesë kur dukshmëria e rrugës nuk është e mjaftueshme, përveç nëse në ato vende nuk ekzistojnë më shumë korsi komunikacioni të shënuara me shenja në rrugë dhe të destinuara ekskluzivisht për lëvizjen e automjeteve në drejtim të lëvizjes së automjetit të tij. (Foto. 58 dhe 59)




Fotografia 58




Fotografia 59

Shoferi nuk duhet të parakalojë automjet tjetër, përveç biçikletës, biçikletës me motor ndihmës, mopedit dhe motoçikletës pa rimorkio anësore, para udhëkryqit ose para dhe në kalimin e rrugës që kalon mbi vijën hekurudhore ose linjën e tramvajit në nivel pa parakolp ose gjysmëparakolp (Foto. 60 dhe 61)




Fotografia 60



Fotografia 61


Para udhëkryqit dhe në udhëkryq, shoferi mund të parakalojë:

1. Automjetin që kthen majtas dhe duke parakaluar në të djathtë (Foto. 62)



Fotografia 62


2. Automjetin që kthen djathtas, por në të njëjtën kohë me automjetin e tij nuk kalon në pjesën e rrugës të destinuar për qarkullimin e automjeteve nga drejtimi i kundërt (Foto. 63)




Fotografia 63

3. Automjetin që lëviz në rrugë me përparësi kalimi, por pastaj me automjetin e tij të mos kalojë në pjesën e rrugës të destinuar për qarkullimin e automjeteve nga drejtimi i kundërt dhe
4. Në rast se komunikacioni në udhëkryq rregullohet me shenja të komunikacionit me drita.

Shoferi nuk duhet të parakalojë automjet tjetër që i afrohet vendkalimit të shënuar për këmbësorë, i cili kalon në vendkalim për këmbësorë ose i cili është ndalur për shkak të lëshimit të këmbësorëve në atë vendkalim. (Foto. 64 dhe 65)



Fotografia 64




Fotografia 65

Në rrugë publike ku ka të paktën dy korsi komunikacioni të destinuara për qarkullim automjetesh në të njëjtin drejtim dhe në të cilën ka kolona automjetesh, shoferi i automjetit mund të largohet nga korsia ku ndodhet vetëm për t'u kthyer majtas ose djathtas ose për të parkuar automjetin. (Foto. 66)




Fotografia 66

Në rrugë publike ku ka të paktën dy korsi komunikacioni të destinuara për qarkullim automjetesh në të njëjtin drejtim dhe në të cilën ka kolona automjetesh, lëvizja më e shpejtë e automjeteve në njërin korsi sesa lëvizja në korsinë tjetër në rrugë nuk konsiderohet parakalim. (Foto. 67)



Fotografia 67

Parakalim nuk konsiderohet as kalimi me automjet në anën e djathtë të automjetit që për lëvizjen e tij nuk e përdor korsinë e komunikacionit përgjatë skajit të djathtë të rrugës (në përputhje me dispozitën për lëvizjen e automjeteve në rrugë publike në vendbanim, me rrugë në të cilën për qarkullimin e automjeteve në të njëjtin drejtim ka të paktën dy korsi komunikacioni të shënuar për lëvizjen e automjetit, shoferi mund të përdor korsinë e komunikacionit që nuk ndodhet përgjatë skajit të djathtë të rrugës, nëse me të nuk i pengon automjetet e tjera që lëvizin prapa automjetit të tij). (Foto. 68)



Fotografia 68

RESPEKTOJI rregullat e ndalimit dhe parkimit

Shoferi, përkatësisht pronari i automjetit, nuk duhet të ndalojë ose parkojë automjetin në vendin ku do të rrezikonte sigurinë e pjesëmarrësve të tjerë në komunikacion ose do të ishte pengesë për zhvillimin normal të komunikacionit ose për lëvizjen e këmbësorëve dhe çiklistëve. (Foto. 69 dhe Foto. 70)



Fotografia 69



Fotografia 70

Në rrugë publike, në vende, përkatësisht në hapësirën e destinuar për ndalimin dhe parkimin e automjeteve, si dhe në zonën e rregulluar posaçërisht për komunikacionin e destinuar për lëvizjen e këmbësorëve dhe çiklistëve, është e ndaluar të lihen automjetet që për shkak të dëmtimit, përkatësisht vjetritimit, nuk përdoren në komunikacion (automjete të shkatërruara, automjete të braktisura, kamp-rimorkio, etj.), si dhe sende të tjera që pengojnë zhvillimin e komunikacionit dhe rrezikojnë mjedisin jetësor. (Foto. 71 dhe Foto. 72)



Fotografia 71



Fotografia 72

Automjetet dhe sendet, pronarët me kërkesë të nëpunësit policor janë të detyruar t'i heqin menjëherë.


Nëse pronarët nuk i heqin ato, si dhe në rast se ata mungojnë, automjetet dhe sendet do të hiqen në shpenzim të pronarëve të tyre.

Largimi i automjeteve dhe sendeve kryhet nga personi juridik kompetent, në lokale të rregulluara posaçërisht për atë qëllim. (Foto. 73)




Fotografia 73

Në rrugë publike jashtë vendbanimit, shoferi, përkatësisht pronari i automjetit, është i detyruar gjithnjë kur për të ekziston mundësia të ndalojë ose ta parkojë automjetin jashtë rrugës. (Foto. 74)



Fotografia 74

Shoferi, përkatësisht pronari i automjetit i cili për shkak të mosfunksionimit të automjetit, fatkeqësisë së komunikacionit ose ndonjë arsye tjetër të justifikuar detyrohet të ndalojë automjetin në rrugë, është i detyruar t'i ndërmarrë të gjitha masat për të mos rrezikuar pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion, ndërsa automjetin të largojë nga rruga më shpejt. (Foto. 75)



Fotografia 75

Nëse shoferi, përkatësisht pronari i mjetit, për shkak të mosfunksionimit të mjetit, fatkeqësisë së komunikacionit ose ndonjë arsye tjetër të justifikuar detyrohet të ndalojë mjetin në binarë, është i detyruar ta heq menjëherë nga binarët, dhe nëse është e pamundur t'i ndërmarrë menjëherë masat e nevojshme: me qëllim që personat që i ngasin mjetet që lëvizin në binarë të paralajmërohen me kohë për rrezikun. (Foto. 76 dhe Foto. 77)



Fotografia 76



Fotografia 77

Shoferi, përkatësisht pronari i automjetit i cili ndalon ose parkon automjetet në rrugë, është i detyruar ta ndalojë, përkatësisht ta parkojë pranë skajit të djathtë të rrugës, ndërsa në rrugën ku komunikacioni zhvillohet vetëm në një drejtim, mund të ndalet, përkatësisht të parkojë automjetin pranë skajit të djathtë ose të majtë të rrugës. (Foto. 78 dhe Foto. 79)



Fotografia 78



Fotografia 79

Nëse përgjatë skajit të djathtë të rrugës ka binarë të tramvajit ose binarë të tjerë, shoferi, përkatësisht pronari i automjetit, është i detyruar të ndalojë ose të parkojë automjetin përgjatë skajit të majtë të rrugës. (Foto. 80)



Fotografia 80

Shoferi, përkatësisht pronari i automjetit, mund të ndalojë ose të parkojë automjetin në vendet që janë në mes të rrugës, vetëm nëse ato vende janë të shënuara me shenjë të përshtatshme të komunikacionit ose me shenjë të rrugës. (Foto. 81)



Fotografia 81

Shoferi, përkatësisht pronari i automjetit, nuk duhet të ndalojë ose të parkojë automjet veçanërisht:

- në vendkalim të shënuar për këmbësorë, si dhe në kalimin e shtegut të biçikletave nëpër rrugë dhe në distancë prej më pak se dhjetë metra nga ato vendkalime,
- në kalim rrugor mbi vijën hekurudhore ose vijën e tramvajit në të njëjtin nivel,
- në vijën hekurudhore ose vijën e tramvajit dhe afër atyre vijave, nëse kjo parandalon qarkullimin e automjeteve që lëvizin në binarë,
- në udhëkryq dhe në distancë prej më pak se dhjetë metra nga skaji më i afërt i rrugës së tërthortë,
- në ura, nënkalime, mbikalime, si dhe në distancë prej më pak se pesëmbëdhjetë metra nga urat, tunelet, nënkalimet dhe mbikalimet,
- në një pjesë të rrugës publike, afër majës së qafës së malit dhe në kthesë ku dukshmëria e rrugës është e pamjaftueshme dhe ku kalimi i automjetit nuk mund të kryhej pa rrezik,
- në një pjesë të rrugës publike, ku gjerësia e kalimit të lirë nga automjeti i ndaluar ose i parkuar deri në vijën e plotë të rrugës ose në ndonjë pengesë në rrugë do të ishte më pak se tre metra, përkatësisht në skajin e kundërt të rrugës do të ishte më pak se katër metra,
- në vendin ku automjeti do të mbulonte shenjën e vendosur të komunikacionit ose pajisjen për dhënien e shenjave të komunikacionit me dritë,
- në shtegun, përkatësisht korsinë e biçikletave,
- në trotuar, përkatësisht shtegun e këmbësorëve, nëse nuk rregullohet në mënyrë eksplicite nga shenja e komunikacionit. Nëse lejohet parkimi, përkatësisht ndalimi, detyrimisht duhet të lihet së paku 1,6 metra gjerësi në zonën për lëvizjen e këmbësorëve, pasi ajo zonë nuk mund të jetë përgjatë skajit të rrugës,
- në një pjesë të rrugës, e cila si ndalesë për mjetet e transportit publik është e shënuar me shenja rrugore,
- në një pjesë të rrugës publike përpara se të kalojë rrugën përmes vijës hekurudhore ose vijës së tramvajit në të njëjtin nivel, në distancë prej më pak se 15 metra nga ato kalime,
- në distancë prej më pak se 15 metra përpara dhe pas shenjës që shënon ndalesën për mjetet e transportit publik,
- para se të hyni në ndërtesë, oborr apo garazh,
- në zonat e gjelbra të rregulluara në mënyrë hortikulturore, gjelbërimin dhe parqet e qytetit,
- mbi lidhjen me rrjetin e ujësjellësit ose hyrjen në kanalizim ose rrjet tjetër të ndërmarrjeve komunale,

- në vendet e parashikuara për lëvizjen dhe parkimin e personave me aftësi të kufizuara,
- në vendin ku automjeti i parkuar do të pamundësonte hyrjen e automjetit tjetër, për shkak të parkimit ose daljes së automjetit të parkuar tashmë,
- në shesh, zonën e këmbësorëve dhe rrugën e zjarrfikësve dhe
- në vendparkim i cili me tabelë shtesë, shenjë komunikacioni ose shenjë rrugore është shënuar vendi i parkimit të automjeteve për personat me aftësi të kufizuara.

Me përjashtim, shoferi i automjetit që kryen transport të taksisë të pasagjerëve mund të ndalet edhe në vendet ose në korsinë e komunikacionit për mjetet e transportit publik të qytetit që nuk është destinuar për lëvizjen e tramvajeve ekskluzivisht për kohën e nevojshme për hyrjen, përkatësisht daljen e pasagjerëve.


Shoferi, përkatësisht pronari i automjetit, është i detyruar të shënojë mjetin motorik, triçikletën, katërçikletën e lehtë, katërçikletën, traktorin, rimorkion dhe mjetin mbrehës që është ndaluar në rrugë me shenjë të veçantë që tregon automjetin e ndaluar në rrugë në rast se:

- kur u detyrua të ndalojë automjetin e tij në vendin ose në pjesën e rrugës;

- kur automjeti ndalet në rrugë në vend të tillë që shoferët e automjeteve që vijnë nga i njëjti drejtim, nuk mund ose vështirë mund ta vërejnë me kohë dhe

- në autostradë dhe në rrugë të rezervuar për komunikacion të mjeteve motorike, si dhe në një pjesë të rrugës që nuk duket sa duhet.

Shenja vendoset në rrugë prapa automjetit të ndaluar, në pozicion vertikal dhe në distancë të mjaftueshme, e cila në rrugë jashtë vendbanimit nuk mund të jetë më pak se 50 m, ndërsa në vendbanim nuk mund të jetë më pak se 15 m. Shenja vendoset në të njëjtën mënyrë kur kolonë automjeteve ndalet në rrugë, në këtë rast vendosen dy shenja në rrugë në vend të njëjës, pranë njëra-tjetrës. (Foto. 82)



Fotografia 82

Nëse mjeti motorik ka pajisje të instaluar për ndezjen e të gjithë treguesve të drejtimit në të njëjtën kohë, ajo pajisje duhet të ndizet.

Dyert nuk duhet t'i hapen automjetit të ndaluar ose të parkuar nëse pengon lëvizjen e pjesëmarrësve të tjerë në komunikacion ose rrezikon sigurinë në komunikacion. (Foto. 83)



Fotografia 83

Kur shoferi, përkatësisht pronari i automjetit, e lë automjetin pa mbikëqyrje të drejtpërdrejtë, është i detyruar t'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që do të parandalojnë përdorimin e paautorizuar të automjetit ose vetëheqjen e automjetit nga vendi ku është lënë, veçanërisht:

- t'i kthejë gomat e përparme në drejtim të trotuarit, përkatësisht rrugës dhe të vendos levën e marshit për ngasjen prapa - nëse automjeti lihet në tatëpjetë, përkatësisht t'i kthejë gomat e përparme drejt mesit të rrugës, të vendos levën e marshit në shkallën e parë dhe të tërheq frenën e parkimit - nëse automjeti është lënë në përpjetë (Foto. 84) dhe




Fotografia 84

- të vendos ronsele thumbore nën gomat e dhura të automjetit, nëse në rrugë me pjerrësi është lënë automjeti i pajisur me ronsele të tilla. (Foto. 85)



Fotografia 85

Në zonën e komunikacionit të destinuar për ndalimin dhe parkimin e automjeteve, në të cilën me shenjë të komunikacionit ose me shenjë të veçantë përcaktohet hapësira dhe mënyra e ndalimit dhe parkimit, shoferi, përkatësisht pronari i automjetit është i detyruar të ndalojë dhe të parkojë automjetin vetëm në hapësirën, përkatësisht mënyrën e përcaktuar. (Foto. 86)



Fotografia 86

Gjatë ndalimit dhe parkimit të automjeteve, shoferi, përkatësisht pronari i automjetit, është i detyruar të lërë hapësirë të mjaftueshme ndërmjet automjetit të tij dhe automjetit që është ndaluar ose parkuar më parë, në mënyrë që shoferi i automjetit të parkuar më parë të mund të hyjë në automjet pa probleme dhe automjeti mund të përfshihet përsëri në komunikacion. (Foto. 87)



Fotografia 87

Në rast të ndalimit të detyruar të automjetit për shkak të fatkeqësisë së komunikacionit, kryerjes së punimeve në rrugë ose në raste të tjera kur është i domosdoshëm ndalimi i automjetit, shoferi nuk duhet të largohet nga automjeti, përveç për t'i dhënë ndihmë personit ose në rast rreziku.

Parking-zona të sigurta familjare

Vende të veçanta të parkimit për gratë shtatzëna dhe shoferët me fëmijë deri në tre vjeç



Fotografia 88

Vendet e rezervuara të parkimit për automjetet përpara institucioneve publike, objekteve të institucioneve mjekësore, qendrave rekreative, sportive dhe tregtare, është nevojë humane me rëndësi të veçantë.

Në vend, përveç vendeve të rezervuara dhe të shënuara posaçërisht për parkim për automjetet për personat me aftësi të kufizuara, u shënuan edhe vendet e veçanta të parkimit për gratë shtatzëna dhe shoferët e mjeteve në të cilat transportohen fëmijët deri në tre vjeç, me vendosjen e shenjave përkatëse, ndërsa automjetet e atyre kategorive të qytetarëve janë shënuar me afişe. (Foto. 88)

Shenja e parkimit në vendet e sigurta të parkimit familjar garanton vend parkimi të rezervuar dhe të zgjedhur me kujdes, por nuk lirohet nga kompensimi i parkimit. Kjo shenjë mund të hiqet në stacionet e kontrollit teknik të LAMM-së në Shkup.

Vendet e para të parkimit janë shënuar në stacionet e kontrollit teknik të LAMM-së në Shkup (Qendër dhe Çair) dhe në Veles, dhe vendet e tjera të shënuara të parkimit janë brenda parkingjeve të menaxhuara nga NP Parkingjet e Qytetit Shkup:

Zona A0 - Vodno e Mesme - janë shënuar 4 vende parkimi

(dy vende në parkimin e epërm dhe dy vende në parkimin e poshtëm)

Zona A3 - Rruga "Dame Gruev", para Stacionit Policor Beko - është shënuar 1 vend parkim

Zona A4 - Rruga "Dame Gruev", prapa Kuvendit të RMV-së - janë shënuar 2 vende parkimi

Zona A5 - Rruga "Orce Nikollov" - është shënuar 1 vend parkim

Zona A8 - Ura e Gurit - janë shënuar 2 vende parkimi

Zona C15 - Rruga "Gjuro Gjakoviq" - është shënuar 1 vend parkim

Zona C80 - "Kopshti Zoologjik" - janë shënuar 3 vende parkimi

Zona D4 - "Vero", Aerodrom ("Instituti i Minerave") - do të shënohen 2 vende parkimi pas përfundimit të punimeve të ndërtimit në parking

Zona D40 - Spitali "8 Shtatori" - janë shënuar 3 vende parkimi

Zona D62 - Klubi i Tenisit "ABC" (Instituti i Blegtorisë) - janë shënuar 2 vende parkimi

Zona D1 - Hotel "Rusia" - janë shënuar 2 vende parkimi

Zona L - Klinika e Gjinekologjisë dhe Akusherisë, Qendra Klinike - janë shënuar 4 vende parkimi

Parking-zonat e sigurta familjare zbatojnë trende evropiane për rritjen e sigurisë në komunikacion, zvogëlimin e numrit të viktimave në komunikacion, si dhe avancimin e kulturës dhe shprehive të komunikacionit.

RESPEKTOJI rregullat e tërheqjes së rimorkios

Në komunikacion në rrugë publike, mjeti motorik mund të plotësohet me maksimum dy rimorkio për transportin e mallrave, përkatësisht një rimorkio për transportin e personave, ndërsa në autostradë dhe në rrugë të rezervuar për qarkullimin e mjeteve motorike - vetëm një rimorkio.

Me mjet motorik mund të tërhiqet vetëm rimorkio që nuk e ul ndjeshëm qëndrueshmërinë e saj. (Foto. 89)



Fotografia 89


Mjeti motorik me pajisje tërheqëse nuk duhet të marrë pjesë në komunikacion në rrugë publike, nëse nuk tërheq rimorkio. (Foto. 90)



Fotografia 90


RESPEKTOJI rregullat e tërheqjes së automjetit me defekt

Mjeti motorik mund të tërheqë automjet tjetër për shkak të mosfunksionimit, përkatësisht mungesës së pjesëve të caktuara, vetëm nëse nuk mund të lëvizë në mënyrë të pavarur. (Foto. 91)



Fotografia 91

Mjeti motorik nuk mund të tërheqë motoçikletë me ose pa rimorkio anësore ose mjet tjetër me dy rrota. (Foto. 92)



Fotografia 92


Mjeti motorik mund të tërheqë mjet tjetër motorik me defekt ditën dhe natën, në kushtet e dukshmërisë së zvogëluar, nëse mjeti i tërhequr ndëz tregues të drejtimeve dhe dritat e shënimit të mjetit ose nëse mjeti motorik përdor dritë të verdhë rrotulluese. (Foto. 93)




Fotografia 93

Gjatë tërheqjes së mjetit, mjeti tërheqës duhet t'i ndez treguesit e drejtimeve, ndërsa mjeti që tërhiqet, nëse i funksionojnë. Të dyja mjetet duhet të shënohen me trekëndësh sigurie.

Trekëndëshi i sigurisë i mjetit tërheqës vendoset në anën e përparme, ndërsa i mjetit që tërhiqet vendoset në anën e pasme. (Foto. 94 dhe 95)



Fotografia 94



Fotografia 95

Me mjetin e tërhequr është i ndaluar transporti i personave, me përjashtim të shoferit që e drejton mjetin.

Mjeti motorik mund të tërhiqet në rrugë me anë të litarit, lidhjes së fortë dhe duke u mbështetur ose varur mjetin në mjetin tërheqës. (Foto. 96, Foto. 97 dhe Foto. 98)



Fotografia 96

Litari nuk duhet të tërhiqet nga mjeti motorik të cilit nuk i funksionojnë pajisjet për drejtimin ose pajisjet për të ndaluar, as mjeti transportues ose autobusi.



Fotografia 97

Lidhja e fortë nuk duhet të tërhiqet nga mjeti motorik i cili nuk ka pajisje që funksionon për drejtim, as mjeti motorik më i rëndë se mjeti tërheqës, nëse freni i tij i punës nuk funksionon.



Fotografia 98


Nëse mjeti motorik tërhiqet nga litari ose lidhja e fortë, personi që drejton mjetin e tërhequr duhet të ketë patentë shoferi nga kategoria e mjeteve të cilave u përket mjeti që tërhiqet.

Tërheqja e mjetit të ngarkuar transportues me ose pa rimorkio, përkatësisht traktori me rimorkio, lejohet vetëm deri në vendin e parë të përshtatshëm për shkarkimin e ngarkesës, me përjashtim edhe deri në vendin e parë ku mund të hiqet mosfunksionimi i mjetit. (Foto. 99)




Fotografia 99

Distanca midis mjetit motorik tërheqës dhe të tërhequr, nëse tërhiqet me litar është tre deri në pesë metra, ndërsa nëse tërhiqet me lidhje të fortë mund të jetë edhe më pak se tre metra. (Foto. 100)



Fotografia 100

Mjeti motorik që tërheq mjet tjetër motorik me defekt në rrugë nuk duhet të lëvizë me shpejtësi më të madhe se 40 km / orë. (Foto. 101)



Fotografia 101

RESPEKTOJI rregullat e përdorimit të dritave në komunikacion

Në komunikacionin rrugor, ditën dhe natën, gjatë ngasjes së automjetit, shoferi i automjetit detyrimisht duhet t'i ketë ndezur të paktën dritat e mesme për të ndriçuar rrugën. (Foto. 102 dhe 103)




Fotografia 102



Fotografia 103


RESPEKTOJE obligimin e distancës midis automjeteve

Shoferi është i detyruar të ngasë automjetin në distancë nga automjetet e tjera që marrin pjesë në komunikacion, e cila korrespondon me shpejtësinë e lëvizjes së automjetit dhe rrethanat e tjera të komunikacionit, ku ajo distancë nga automjetet e tjera nuk shkakton rrezik dhe nuk i pengon shoferët e tjerë. (Foto. 104)



Fotografia 104


Kur në rrugë publike jashtë vendbanimit që ka vetëm një kors komunikacioni të destinuar për qarkullimin e automjeteve në një drejtim, lëvizin nga një mjet motorik njëri pas tjetrit, masa maksimale e lejuar e të cilit është më e madhe se 3,500 kg, gjatësia e të cilit është më e madhe se shtatë metra, shoferët janë të detyruar të mbajnë distancë prej të paktën 100 m ndërmjet secilit prej këtyre mjeteve. Kjo dispozitë nuk i referohet pjesës së rrugës publike ku ndalohet parakalimi. (Foto. 105)




Fotografia 105

RESPEKTOJE obligimin e shoferëve ndaj këmbësorëve

Nëse komunikacioni në vendkalim të shënuar për këmbësorë rregullohet me shenjat e komunikacionit me dritë ose me shenjat që i jep nëpunësi policor, shoferi është i detyruar të ndalojë automjetin e tij para vendkalimit për këmbësorë, kur me shenjën e dhënë i ndalohet kalimi, dhe nëse në vendkalim të tillë me shenjën e dhënë lejohet të kalojë shoferi nuk duhet të pengojë kalimin e këmbësorëve të cilët tashmë kanë shkelur në vendkalimin për këmbësorë. (Foto. 106 dhe Foto. 107)




Fotografia 106



Fotografia 107


Nëse vendkalimi i shënuar për këmbësorë është i vendosur në hyrje në rrugë anësore, shoferi i cili kthen në atë rrugë është i detyruar të bëjë kthesën me shpejtësi të zvogëluar dhe t'i lëshojë këmbësorët që tashmë kanë shkëlur ose që shkelin në vendkalimin për këmbësorë, dhe nëse është e nevojshme ta ndalojë automjetin e tij. (Foto. 108)



Fotografia 108

Nëse komunikacioni në vendkalimin e shënuar për këmbësorë nuk rregullohet nga pajisjet për dhënien e shenjave të komunikacionit me drita, as nga shenjat e nëpunësit policor, shoferi është i detyruar t'i afrohet vendkalimit të tillë për këmbësorë me shpejtësi mjaft të konsiderueshme dhe të ndalojë automjetin e tij për t'i lëshuar dhe për të mos i rrezikuar këmbësorët që kanë shkëlur ose që shkelin në vendkalimin për këmbësorë.

Shoferi i cili kthen në rrugë anësore, në hyrje të së cilës nuk ka vendkalim të shënuar për këmbësorë, është i detyruar të bëjë kthesën me shpejtësi të zvogëluar dhe t'i lëshojë këmbësorët që tashmë kanë shkëlur në rrugë. (Foto. 109)



Fotografia 109

Shoferi i cili me automjet kalon në zonën e destinuar për lëvizjen e këmbësorëve (lëvizja në trotuar, dalja nga garazhi, oborri ose zona tjetër që nuk është e destinuar për komunikacion publik), nuk duhet të rrezikojë ose të pengojë lëvizjen e këmbësorëve.

Shoferi që lëviz me automjet në rrugë në të cilën ka ujë është i detyruar të përshtatë ngasjen në mënyrë që të mos i spërkasë këmbësorët, çiklistët, biçikletat me motor ndihmës, mopedët, motoçikletat, triçikletat, katërçikletat e lehta dhe katërçikletat.

Shoferi i automjetit nuk duhet të kalojë në kolonën e fëmijëve, njësisive të Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe policisë, kortezhin e përmortshëm, si dhe çdo kortezh tjetër i organizuar i qytetarëve që lëviz në rrugë. (Foto. 110)



Fotografia 110

RESPEKTOJI rregullat e komunikacionit për kalimin e rrugës nëpërmjet vijës hekurudhore

Shoferi i cili me automjet afrohet në vendkalimin rrugor përmes vijës hekurudhore në të njëjtin nivel është i detyruar të përshtatë lëvizjen e automjetit në mënyrë që ta ndalojë përpara pajisjes për mbylljen e komunikacionit në vendkalim ose përpara pajisjes për dhënien e shenjave që njofton afrimin e trenit, përkatësisht mundësinë për të ndaluar automjetin para se të hyjë në vijën hekurudhore. (Foto. 111)

Shoferi i automjetit që i afrohet kalimit është i detyruar të ndalet në shenjë e punëtorëve të autorizuar në fushën e komunikacionit hekurudhor.



Fotografia 111

Pjesëmarrësit në komunikacion janë të detyruar të ndalojnë para se të kalojnë në rrugë publike përmes vijës hekurudhore në të njëjtin nivel, nëse pajisja e ndalimit të komunikacionit është ulur, ose nëse ajo pajisje tashmë ka filluar të ulet, ose nëse jepen shenjat e dritës ose shenjat e zëshme që paralajmërojnë se pajisja do të fillojë të ulet, përkatësisht që treni po vjen drejt kalimit të rrugës përmes vijës hekurudhore. (Foto. 112)



Fotografia 112

Para se të kalojë rrugën përmes vijës hekurudhore në të njëjtin nivel, ku vendosen shenjat e komunikacionit me dritë, pjesëmarrësit në komunikacion janë të detyruar të ndalojnë kur do të shfaqet drita e kuqe vezulluese ose drita e kuqe e pandërprerë. (Foto. 113)



Fotografia 113

Pjesëmarrësit në komunikacion që kalojnë përmes vijës hekurudhore në të njëjtin nivel janë të detyruar ta bëjnë këtë me kujdes të veçantë edhe kur dritat e kalimit nuk janë të ndezura.


Në kalimin e rrugës përmes vijës hekurudhore në të njëjtin nivel, ku nuk ka pajisje për mbylljen e komunikacionit, as pajisje për të dhënë shenja që njoftojnë afrimin e trenit, pjesëmarrësit në komunikacion mund të kalojnë përmes vijës hekurudhore vetëm pasi do të sigurohen më parë që në vijën hekurudhore nuk vjen treni ose ndonjë mjet tjetër që lëviz në binarë. (Foto. 114)



Fotografia 114

RESPEKTOJI rregullat e komunikacionit në autostradë, rrugën ekspres dhe në rrugën e rezervuar për komunikacionin e automjeteve


Në autostradë, rrugë ekspres dhe rrugë të rezervuar për qarkullim të mjeteve motorike, nuk duhet të lëvizin këmbësorët, biçikletat, makinat lëvizëse, motokultivatorët, traktorët, mjetet mbrehëse dhe bagëtia, as automjetet që sipas LSKRR-së nuk konsiderohen mjete motorike, përveç motoçikletave, fuqia e motorit e të cilave është më e madhe se 35 kilovat. (Foto. 115)



Fotografia 115


Në autostradë, rrugë ekspres dhe rrugë të rezervuar për qarkullim të mjeteve motorike, nuk duhet të lëvizin as mjetet motorike, të cilat sipas vetive të tyre të ndërtimit nuk mund të lëvizin me shpejtësi prej të paktën 60 km / orë. Kjo dispozitë nuk u referohet automjeteve të Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, policisë, si dhe automjeteve të personit juridik kompetent për mirëmbajtjen e rrugëve, kur japin shenja të veçanta të dritës (dritë të verdhë vezulluese).

Në autostradë, rrugë ekspres dhe rrugë të rezervuar për qarkullim të mjeteve motorike, shoferi nuk duhet të ndalet dhe të parkojë automjetin, përveç në zonat jashtë rrugës të cilat janë rregulluar dhe shënuar posaçërisht për të. (Foto. 116)




Fotografia 116

Shoferi i cili për shkak të mosfunksionimit të automjetit ose për arsye të tjera është i detyruar të ndalojë automjetin në rrugë nga autostrada, rruga ekspres, përkatësisht nga rruga e rezervuar për qarkullim të mjeteve motorike, është i detyruar ta ndalojë atë në korsinë e veçantë për ndalimin e detyruar të automjetit, nëse ekziston në atë vend dhe t'i ndër marrë masat e nevojshme për të hequr automjetin nga rruga sa më shpejt të jetë e mundur. (Foto. 117)



Fotografia 117

Në autostradë, rrugë ekspres dhe rrugë të rezervuar për qarkullim të mjeteve motorike, shoferi nuk duhet të bëjë kthesë gjysmërrethore me automjetin nga një drejtim i komunikacionit në drejtim të kundërt, dhe as ta lëvizë automjetin prapa. (Foto. 118)



Fotografia 118

Në autostradë, rrugë ekspres dhe rrugë të rezervuar për qarkullim të mjeteve motorike, nuk duhet të përfshihet mjeti motorik që tërheq mjet tjetër motorik, i cili për shkak të defektit ose mungesës së pjesëve të caktuara nuk mund të lëvizë. (Foto. 119)



Fotografia 119

Me përjashtim, tërheqja e automjetit lejohet në autostradë, rrugë ekspres, përkatësisht në rrugën e rezervuar për qarkullim të mjeteve motorike, nëse arsyeja e tërheqjes ka ndodhur gjatë lëvizjes së mjetit motorik në autostradë, rrugë ekspres, përkatësisht në rrugën e rezervuar për qarkullim të mjeteve motorike, por vetëm përgjatë korsisë së djathtë deri në rrugën e parë lidhëse, pas së cilës automjeti i tërhequr mund të largohet nga komunikacioni në autostradë, rrugë ekspres, përkatësisht rrugë të rezervuar për qarkullimin e mjeteve motorike. (Foto. 120)




Fotografia 120

Në autostradë, rrugë ekspres dhe rrugë të rezervuar për qarkullim të mjeteve motorike, mjetet motorike lëvizin përgjatë korsisë së djathtë të komunikacionit, e cila nuk është e zënë nga automjetet në kolonë. (Foto. 121 A)



Fotografia 121 A

Në autostradë, rrugë ekspres dhe rrugë të rezervuar për qarkullim të mjeteve motorike, shoferi mund të ndryshojë korsinë për lëvizje më të shpejtë, vetëm duke kaluar automjetin në korsinë e majtë. (Foto. 121 B)



Fotografia 121 B

Në autostradë, rrugë ekspres dhe rrugë të rezervuar për qarkullim të mjeteve motorike, shoferi nuk duhet të ngasë automjetin në korsinë e komunikacionit për ndalim të detyruar, as të lëvizë në mënyrën që pamundëson distancë të përshtatshme midis automjetit të tij dhe automjetit që lëviz para tij.

Në autostradë, rrugë ekspres ose rrugë të rezervuar për qarkullim të mjeteve motorike, shoferi nuk duhet me automjet t'i përshpejtojë automjetet që lëvizin para tij duke dhënë shenja të dritës dhe shenja të zëshme ose në ndonjë mënyrë tjetër, as të ndërmarrë ndonjë veprim tjetër që rrezikon sigurinë e pjesëmarrësve në komunikacion.


Në autostradë, rrugë ekspres dhe rrugë të rezervuar për qarkullim të mjeteve motorike, me tre ose më shumë korsi të destinuara për qarkullimin e automjeteve në një drejtim, shoferët e mjeteve transportuese, masa e së cilës maksimale e lejuar është më e madhe se 3.500 kg dhe të një grupi automjeteve, gjatësia e të cilave është më e madhe se shtatë metra, mund t'i përdorin vetëm dy korsi të komunikacionit të vendosura në skajin e djathtë të rrugës. (Foto. 122)



Fotografia 122


Shoferi i cili me mjet motorik përfshihet në komunikacion në autostradë, rrugë ekspres, përkatësisht në rrugën e rezervuar për qarkullim të mjeteve motorike, është i detyruar që:

- Të përdor korsi të veçantë për përshpejtim, kur një korsi e tillë ekziston në rrugën lidhëse dhe të përfshihet në komunikacion në autostradë, përkatësisht në rrugën e rezervuar për qarkullimin e mjeteve motorike, duke dhënë shenjë të përshtatshme në mënyrën që nuk rrezikon komunikacionin e automjeteve që lëvizin në autostradë, respektivisht rrugën e rezervuar për qarkullimin e mjeteve motorike (Foto. 123) dhe




Fotografia 123

- T'i lëshojë automjetet që lëvizin në autostradë, përkatësisht në rrugën e rezervuar për qarkullimin e mjeteve motorike, nëse në vendin ku përfshihet në komunikacionin në autostradë, nuk ka korsi të veçantë të përshpejtimit (Foto. 124).



Fotografia 124

Shoferi i cili me automjetin largohet nga komunikacioni në autostradë, rrugë ekspres, përkatësisht në rrugën e rezervuar për qarkullim të mjeteve motorike, është i detyruar që me automjetin e tij me kohë të marrë pozicion në korsinë e djathtë dhe të kalojë në korsinë e veçantë për përshpejtim sa më shpejt të jetë e mundur, nëse korsi e tillë ekziston në hyrjen e rrugës lidhëse (Foto. 125).



Fotografia 125

Në rast të bllokimit të komunikacionit në autostradë, rrugë ekspres, përkatësisht në rrugën e rezervuar për qarkullim të mjeteve motorike, automjetet detyrimisht duhet të lënë hapësirë të mjaftueshme në anën e majtë të korsisë, për lëvizjen e automjeteve të policisë, ambulancave dhe mjeteve të zjarrfikësve. (Foto. 126)



Fotografia 126

RESPEKTOJI rregullat e komunikacionit në tunel

Shoferi i cili lëviz me automjet në tunel, nuk duhet të ndalojë automjetin në tunel, as nuk duhet të bëjë kthesë gjysmërrethore ose të lëvizë prapa. (Foto. 127)

Shoferi i automjetit është i detyruar gjatë lëvizjes në tunel t'i ketë të ndezur dritat e mesme për ndriçimin e rrugës.



Fotografia 127

RESPEKTOJI rregullat e automjeteve në shoqërim

Automjete në shoqërim janë automjetet që janë të shoqëruara nga automjetet e policisë ose nga personat ushtarakë në mjete të veçanta motorike, të pajisura me pajisje për të dhënë shenja të veçanta të zërit dhe dritës në ngjyrë të kaltër dhe të kuqe, derisa jepen ato shenja. (Foto. 128)




Fotografia
128

Shoferi i cili në rrugë has automjet ose kolonë automjesh në shoqërim dhe shoferi i cili do të parakalohet nga automjeti ose kolona e automjeteve në shoqërim është i detyruar të ndalojë automjetin e tij - gjatë natës në vend të dritave të gjata të përdor drita të mesme për të ndriçuar rrugën, t'u përmbahet rreptësishtë urdhrave që ia japin personat në shoqërim dhe të vazhdojë lëvizjen vetëm pasi të kenë kaluar të gjitha automjetet në shoqërim. (Foto. 129)




Fotografia
129

Automjetet në shoqërim, duke marrë parasysh sigurinë e pjesëmarrësve të tjerë në komunikacion, kanë të drejtën e përparësisë së kalimit ndaj të gjitha automjeteve të tjera, përveç automjeteve që lëvizin në udhëkryq ku komunikacioni rregullohet nga shenjat e komunikacionit me drita ose shenjat që i jep nëpunësi policor. (Foto. 130, 131, 132 dhe 133)



Fotografia 130



Fotografia 131



Fotografia 132



Fotografia 133

Për automjetet në shoqërim nuk zbatohen dispozitat në lidhje me:

- obligimin për t'u lidhur me rrip të sigurimit,
- ndalimin e përdorimit të celularit dhe pajisjeve të tjera audio dhe video,
- kufizimin e shpejtësisë,
- ndalimin e parakalimit dhe kalimit të kolonës së automjeteve,
- obligimet në lidhje me lëvizjen e këmbësorëve që kanë shkelur në vendkalimin për këmbësorë,
- ndalimin e prerjes së kolonës së këmbësorëve,
- si dhe për kalimin nga njëra kors në korsinë tjetër të komunikacionit.

Automjetet në shoqërim nuk janë të detyruara të lëvizin njëri pas tjetrit.

Në rastet kur është e domosdoshme, dhe duke marrë parasysh sigurinë e pjesëmarrësve të tjerë në komunikacion, për automjetet në shoqërim nuk zbatohen as dispozitat në lidhje me:

- përfshirjen në komunikacion,
- ndalimin dhe parkimin e automjetit dhe
- anën e lëvizjes së automjetit.

Për të mundësuar kalimin e papenguar të automjeteve në shoqërim, këmbësorët janë të detyruar të largohen nga rruga derisa ato automjete të kenë kaluar.

RESPEKTOJI rregullat e automjeteve me përparësi kalimi

Automjete me të drejtë të përparësisë së kalimit janë: automjetet e shërbimit të ndihmës së shpejtë, automjetet e shërbimit të zjarrfikësve, automjetet e policisë dhe automjetet e Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut (Foto. 134)



Fotografia 134

Për automjetet e shërbimit të ndihmës së shpejtë, automjetet e shërbimit të zjarrfikësve, automjetet e policisë dhe automjetet e Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, kur me pajisje të veçanta japin shenja të dritës dhe të zëshme, nuk do të zbatohen dispozitat e këtij ligji për obligimin:

- për t'u lidhur me rrip të sigurimit,
- për t'u ndaluar për përdorimin e celularit dhe pajisjeve të tjera,
- për kufizimin dhe mënyrën e ndryshimit të shpejtësisë,
- për ndalimin e parakalimit dhe kalimit të kolonës së automjeteve dhe
- për ndalimin e prerjes së kolonës së këmbësorëve.

Këto automjete kanë të drejtën e përparësisë së kalimit lidhur me të gjitha automjetet e tjera, përveç automjeteve në shoqërim dhe automjeteve që lëvizin në udhëkryq ku komunikacioni rregullohet nga shenjat e komunikacionit me drita ose shenjat e nëpunësit policor të uniformuar, me kusht që të mos rrezikojnë sigurinë e pjesëmarrësve të tjerë në komunikacion.

Për të mundur kalimin e automjeteve me të drejtën e përparësisë së kalimit, këmbësorët janë të detyruar të largohen nga rruga, t'i lëshojnë automjetet e tjera dhe nëse është e nevojshme, të ndalen derisa të kalojnë ato automjete.

Kur automjeti i policisë ose i Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke përdorur dritat e kaltra i siguron kalimin një automjeti ose një kolone të automjeteve që lëvizin prapa tij, shoferët janë të detyruar t'u kushtojnë vëmendje edhe automjeteve të cilave u sigurohet kalimi, për t'i lëshuar, nëse është e nevojshme, edhe t'i ndalojnë automjetet e tyre derisa të kalojnë ato automjete. (Foto. 135 dhe 136)



Fotografia 135



Fotografia 136

Lidhur me të drejtën e ndërsjellë të përparësisë së kalimit të automjeteve, dispozitat e këtij ligji për përparësinë e kalimit zbatohen në mënyrë të përshtatshme.

Pajisjet për dhënien e shenjave të veçanta të dritës dhe shenjave të zëshme mund të instalohen dhe përdoren vetëm në automjetet me të cilat policia ose policia ushtarake janë në shoqërim, në automjetet e përcaktuara me akt të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në automjetet me të drejtën e përparësisë së kalimit.

Automjetet me të drejtën e përparësisë së kalimit mund t'i përdorin pajisjet e veçanta që japin shenja të dritës dhe shenja të zëshme, vetëm në rast të shpëtimit të jetës njerëzore, të mirave materiale, prishjes së rendit dhe qetësisë publike, si dhe për ndjekjen e kryerësve të veprave penale dhe kundërvajtjeve.

RESPEKTOJI rregullat e transportit të personave me automjete

Me mjet motorik mund në komunikacionin rrugor të transportohen personat në numrin e shënuar në lejen e komunikacionit, përkatësisht në certifikatën e regjistrimit, përveç nëse përcaktohet ndryshe me këtë ligj. (Foto. 137)



Fotografia 137

Në automjetin e pasagjerëve, në sediljen e përparme nuk duhet të transportohet fëmija më i vogël se 12 vjeç ose personi që është nën ndikimin e alkoolit, drogës ose substancave të tjera psikotrope.

Në automjetin e pasagjerëve, në sediljen e pasme mund të transportohet fëmija që është më i vogël se pesë vjeç, në sediljen e veçantë dhe të vendosur për fëmijë e cila është e lidhur me sediljen e automjetit me rrip të sigurimit ose në mënyrë tjetër të përshtatshme. (Foto. 138)



Fotografia 138

Në automjetin e pasagjerëve, në sediljen e përparme mund të transportohet fëmija deri në dy vjeç, nëse automjeti nuk ka jastëk mbrojtës të ajrit, nëse jastëku mbrojtës i ajrit është i fikur dhe nëse fëmija transportohet në sedilje të veçantë për fëmijë të vendosur në anën e kundërt nga drejtimi i lëvizjes, me ç'rast ai është i lidhur në sediljen e automjetit me rripin e sigurimit me tri pika të lidhjes. (Foto. 139)



Fotografia 139

Fëmija duhet të lidhet me rrip të sigurimit të sediljes.

Personi që transportohet me automjet nuk duhet në asnjë mënyrë të pengojë shoferin në ngasjen e automjetit, të ndikojë te shoferi për të ngasur automjetin në mënyrën që zvogëlon sigurinë në komunikacion, dhe as të ndër marrë veprime që rrezikojnë sigurinë e tij ose sigurinë e të tjerëve (hapja e derës, ngjitja në dritare, kërcimi nga automjeti, etj.).

Në hapësirën e mbyllur të mjetit ose rimorkios, e cila nuk mund të hapet nga brenda, shoferi nuk duhet të transportojë persona, përveç në automjetet e Ministrisë së Punëve të Brendshme, organeve të jurisprudencës, Drejtorisë së Doganave, Drejtorisë së Policisë Financiare, Policisë Pyjore dhe Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut. (Foto. 140)



Fotografia 140

Në rimorkio të tërhequr nga mjete motorik, në kamp-rimorkio dhe rimorkio të lehta të tërhequra nga mjete motorike nuk mund të transportohen persona. (Foto. 141)



Fotografia 141

Në pjesët e jashtme të mjetit motorik ose rimorkios, mund të transportohen vetëm personat të cilët kryejnë punë në vendin e tyre të punës në mënyrën e tillë me automjetin (automjeti i zjarrfikësve, automjeti i higjienës komunale, automjeti i shpërndarjes së energjisë elektrike, etj.). (Foto. 142)



Fotografia 142

Në zonën e automjeteve në të cilat transportohen personat, nuk duhet të transportohen në të njëjtën kohë edhe kafshët. (Foto. 143)



Fotografia 143

Me përjashtim, në automjetin e pasagjerëve mund të transportohen kafshët, vetëm në kutitë mbrojtëse të bëra në mënyrë të posaçme. (Foto. 144)



Fotografia 144

RESPEKTOJI shenjat që pjesëmarrësve në komunikacionin rrugor ua japin nëpunësit policorë të uniformuar të Ministrisë së Punëve të Brendshme

Pjesëmarrësit në komunikacion veprojnë sipas kërkesave të shprehura me ndihmën e shenjave ose sipas urdhrave të nëpunësve policorë të uniformuar ose personave të tjerë të autorizuar zyrtarë.

Nëpunësi policor i uniformuar, përkatësisht personi i autorizuar zyrtar, kur jep shenja është i detyruar të ndalet në rrugë në mënyrë që pjesëmarrësit në komunikacion për të cilët janë paraparë shenjat, të mund lehtësisht dhe nga distanca e mjaftueshme ta shohin. Shenjat mund të jepen edhe nga automjeti.

Shenjat e dhëna pjesëmarrësve në komunikacionin rrugor nga nëpunësit policorë të uniformuar të Ministrisë së Punëve të Brendshme janë me duar dhe me pozicionin e trupit, shenjat e zëshme dhe shenjat e dritës.

Shenjat detyrimisht duhet të jepen në mënyrë që kuptimi i tyre për pjesëmarrësit në komunikacion të jetë i qartë.

Nëse nëpunësi policor e rregullon komunikacionin në udhëkryq, shenjat që urdhërojnë ndalimin e të gjitha automjeteve dhe ndalimin e kalimit për pjesëmarrësit e caktuar në komunikacion, mund t'i japë vetëm nëse është në qendër të udhëkryqit.

Nëse në një udhëkryq ndodhen më shumë nëpunës policorë që ndihmojnë në rregullimin e komunikacionit, shenjat e dhëna nga këta persona duhet të harmonizohen me shenjat e dhëna nga nëpunësi policor që ndodhet në qendër të udhëkryqit.

Me përjashtim, nëse kjo do të rregullonte komunikacionin në mënyrë më efektive, shenjat mund të jepen edhe nga nëpunësi policor, i cili ndodhet në rrugë në udhëkryq, me kusht që nëpunësi të mund të vërehet lehtësisht nga të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion të cilëve u dedikohen shenjat.

Për të dhënë shenja që urdhërojnë ndalimin, ndalimin e kalimit, zvogëlimin dhe përshpejtimin e lëvizjes së automjeteve, nëpunësi policor mund të përdor tabelë për rregullimin e komunikacionit.

Tabela për rregullimin e komunikacionit ka formën e rrethit me diametër prej të paktën 12 cm. Baza e tabelës është e bardhë, me skaj të kuq me gjerësi të paktën 2 cm. Në mes të tabelës shkruan fjala "STOP - POLICIA".

Tabela për rregullimin e komunikacionit është bërë me material reflektues. (Foto. 145)

Fotografia 145



Shenjat e dhëna nga nëpunësit policorë me duar dhe me pozicionin e trupit, për pjesëmarrësit në komunikacion i kanë këto kuptime:







1	<p>Dora e ngritur vertikalisht me pëllëmbë të hapur - do të thotë ndalimi i të gjitha automjeteve.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nëse shenja jepet në udhëkryq, për automjetet do të thotë ndalim i kalimit, përveç për ato automjete që në momentin kur nëpunësi policor do ta ngrëjë dorën, nuk mund të ndalen në mënyrë të sigurt. - Nëse shenja jepet në udhëkryq, për këmbësorët do të thotë ndalimi i kalimit të rrugës. - Nëse shenja jepet në rrugë të hapur, ajo e ka kuptimin e theksuar vetëm kur nëpunësi policor është në rrugë. 	
2	<p>Dora e shtrirë horizontale me pëllëmbë të hapur - do të thotë ndalim i kalimit për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion, drejtimi i lëvizjes së të cilit e pret drejtimin e dorës së shtrirë.</p>	
3	<p>Të bërit e ngadaltë me dorën e shtrirë horizontalisht anash në drejtimin lart e poshtë me pëllëmbën e hapur të kthyer poshtë - do të thotë që shoferi në drejtimin e të cilit jepet kjo shenjë duhet të zvogëlojë shpejtësinë e lëvizjes së automjetit.</p>	
4	<p>Dora e shtrirë horizontalisht me pëllëmbën e hapur dhe lëvizje rrethore të parakrahut dhe pëllëmbës nga e djathta në të majtë - do të thotë që shoferi në drejtimin e të cilit është dhënë kjo shenjë duhet të përshpejtojë lëvizjen e automjetit.</p>	
5	<p>Dora e shtrirë horizontalisht anash me pëllëmbën e hapur të orientuar drejt automjetit të caktuar - do të thotë që shoferi i atij automjeti duhet të ndalojë automjetin që nget.</p>	
6	<p>Trupi në pozicionin në këmbë ose trupi në të njëjtin pozicion me duart e shtrirë horizontalisht anash - do të thotë që automjetet që vijnë nga drejtimi në të cilin është kthyer prapa, përkatësisht gjoksi i nëpunësit policor duhet të ndalen, ndërsa automjetet që vijnë nga pjesët anësore të atij personi kanë të drejtë të kalimit.</p>	

Tabela 4

Kur komunikacioni ndalet me shenjat që urdhërojnë ndalimin e automjeteve të pjesëmarrësve të caktuar në komunikacion, nëpunësi policor mund t'u japë shenjë pjesëmarrësve të tjerë për të përshpejtuar lëvizjen e automjetit të tij, nëse me të sigurohet zhvillimi më i shpejtë i komunikacionit.

Shenjat e zëshme jepen me pajisje të veçantë për dhënien e shenjave të zëshme të mjetit motorik ose me bilbil.

Shenjat e zëshme të dhëna nga pajisja e veçantë e mjetit motorik, përbëhen nga një numër tonësh me lartësi, intensitet dhe dinamikë të ndryshme (zëri i ulëritjes).

Shenjat e zëshme me bilbil përdoren vetëm në kombinim me shenjat që jepen me dorë vetëm kur nëpunësi policor është jashtë automjetit (Foto. 146).



Fotografia 146

Shenjat e zëshme të dhëna nga nëpunësit policorë me bilbil i kanë këto kuptime:

- 1. Një fishkëllimë e shkurtër - do të thotë thirrje për pjesëmarrësit në komunikacion kur do ta dëgjojnë këtë zhurmë për ta kthyer vëmendjen te nëpunësi policor, i cili me ndihmën e shenjës tjetër të caktuar do të shprehë kërkesë të caktuar (jepet vetëm kur rregullon komunikacionin në udhëkryq);**
- 2. Shumë fishkëllima të shkurtra radhazi - do të thotë që ndonjë nga pjesëmarrësit në komunikacion ka vepruar në kundërshtim me kërkesën e shprehur me ndihmën e shenjës tjetër të dhënë, të rregullave të komunikacionit ose shenjave të përcaktuara të komunikacionit;**
- 3. Një fishkëllimë e gjatë me dorën e ngritur vertikalisht - do të thotë vëmendje dhe ndalim i detyrueshëm për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion.**

Nëse shenja e zëshme përbëhet nga shumë fishkëllima radhazi, të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion që do të dëgjojnë shenjën e tillë duhet me vëzhgimin e nëpunësit policor të shohin nëse shenja vlen për ta. Në të njëjtën kohë me dhënien e asaj shenje, nëpunësi policor duhet të tregojë se cilit pjesëmarrës në komunikacion i referohet shenja e dhënë dhe çfarë duhet të bëjë ai.

Në kontrollimin dhe rregullimin e komunikacionit, nëpunësit policorë mund të japin shenja me dritë.

Shenjat me dritë jepen nga pajisjet e posaçme për dhënien e shenjave të dritës në mjetin motorik ose me mjete që përdoren me dorë (llambë, "stop-tabelë" me dritë).

"Stop-tabela" me dritë ka formën e rrethit prej 19.5 cm, me skaj të kuq 3 cm të gjerë, baza e të cilit në pjesën e përparme dhe pjesën e pasme është e bardhë. Në mes të pjesës së përparme ka trup të dritës me ngjyrë të kuqe në formë rrethore prej 10 cm, ndërsa në mes të pjesës së pasme është shkruar me shkronja të zeza fjala "STOP-POLICIA".

"Stop-tabela" me dritë ka mbajtëse dhe ajo është e bërë me material reflektues. (Foto. 147)



Fotografia 147

Shenja e dritës që jepet me mjetet që përdoren me dorë (llamba, "stop-tabela" me dritë) është me dritë të kuqe të vazhdueshme, me të cilën nëpunësi policor bën me dorë vertikalisht në boshtin përgjatë rrugës. Kjo shenjë do të thotë që shoferi duhet të ndalojë automjetin që lëviz në pjesën e rrugës në të cilën jepet ajo shenjë e dritës.

Shenjat e dritës të dhëna nga pajisjet e veçanta për dhënien e shenjave të dritës mjetit motorik i kanë këto kuptime:

1. Dy drita vezulluese, një me ngjyrë të kaltër në të djathtë dhe një me ngjyrë të kuqe në të majtë të automjetit, nënkuptojnë që kur shoferi do t'i has mjetet motorike që janë në shoqërim, ose kur do të tejkalohen nga ato automjete, duhet të ndalojë automjetin; natën, në vend të dritave të gjata, të përdor drita të mesme për të ndriçuar rrugën, si dhe t'u përmbahet rreptësisht urdhrave të dhëna nga personat në shoqërim, ndërsa lëvizjen ta vazhdojë vetëm pasi të kenë kaluar të gjitha automjetet në shoqërim, t'u lëshojë përparësinë e kalimit atyre automjeteve dhe të mos i kalojnë ato. Shenja e dritës për këmbësorët do të thotë të largohen nga rruga, për shkak të lëshimit të atyre mjeteve motorike. (Foto. 148)



Fotografia 148

2. Dy drita vezulluese ose rrotulluese me ngjyrë të kaltër në automjet që sigurojnë kalimin e një automjeti ose të kolonës së automjeteve që lëvizin prapa tij, do të thotë që shoferi duhet t'u kushtojë vëmendje automjeteve që u sigurohet kalimi, t'i lëshojë dhe nëse është e nevojshme ta ndalojë automjetin derisa të kalojë automjeti ose kolona e automjeteve. (Foto. 149)



Fotografia 149

3. Një dritë vezulluese ose rrotulluese me ngjyrë të kaltër në automjet me të drejtën e përparësisë së kalimit do të thotë që shoferi që do ta shoh atë dritë, përveç shoferit të automjetit në shoqërim, duhet t'i lirojë përparësi kalimi automjetit nga i cili jepet ajo shenjë dhe nëse është e nevojshme të ndalojë automjetin e tij derisa të kalojë automjeti, ndërsa për këmbësorët do të thotë që për shkak të lëshimit të automjetit duhet të largohen nga rruga. (Foto. 150)

Fotografia 150



Shenjat e dritës jepen në mënyrë që ato të jenë të dukshme për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion për të cilët janë destinuar.

DETYRAT NË RAST TË FATKEQËSISË SË KOMUNIKACIONIT

Personi që do të gjendet ose do të hasë në fatkeqësi të komunikacionit në të cilin ka persona të lënduar, brenda njohurive dhe aftësive të tij siguron ndihmë për personat e lënduar në fatkeqësi komunikacioni (Foto. 151 - fatkeqësi komunikacioni).



Fotografia 151

Pjesëmarrësi në fatkeqësi komunikacioni, në të cilën personi ka vdekur ose është lënduar ose ka ndodhur dëmtim i madh material, si dhe në rast kur ka ndodhur dëmtimi i vogël material, ndërsa kushtet për plotësimin e Raportit Evropian nuk janë përmbushur, është i detyruar:

- Të qëndrojë në vendin e fatkeqësisë së komunikacionit, duke qenë në gjendje të largohet përkohësisht vetëm me qëllim të dhënies së ndihmës personave të lënduar në fatkeqësinë e komunikacionit ose nëse ai ka nevojë për ndihmë mjekësore,
- Të ndërmarrë masa përkatëse në mënyrë që të mënjanojnë rreziqet e reja që mund të ndodhin në vendin e fatkeqësisë së komunikacionit, dhe në veçanti të vendosë shenjën e veçantë për shënjimin e automjetit të ndaluar në rrugë; ose me shenja të tjera përkatëse për t'i njoftuar pjesëmarrësit në komunikacion për rrezikun, për të siguruar automjetin nga vetëshkatërimi, për të siguruar që ngarkesa e automjetit mos të bjerë ose të mos shembet në rrugë, për të ndërmarrë masa për të parandaluar shpërthimin e zjarrit ose shpërthimi, etj., dhe
- Të njoftojë Ministrinë e Punëve të Brendshme në lidhje me fatkeqësinë e komunikacionit dhe të kthehet në vendin e fatkeqësisë së komunikacionit dhe të pres ardhjen e nëpunësit policor i cili do të inspektojë.

Pjesëmarrësi në fatkeqësi komunikacioni, kur i ndërmerr veprimet e theksuara, është i detyruar të përpiqet që të mos ndryshojë gjendjen e vendit të fatkeqësisë së komunikacionit - me qëllim të ruajtjes së gjurmëve ekzistuese, vetëm me kusht që të mos rrezikojë sigurinë në komunikacion.

Ministria e Punëve të Brendshme është e detyruar të njoftojë menjëherë institucionin më të afërt shëndetësor për fatkeqësinë e komunikacionit në të cilën personi ka vdekur ose është lënduar.

Shoferi i cili do të gjendet ose do të has në vendin e fatkeqësisë së komunikacionit është i detyruar me kërkesë të nëpunësit policor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të transportojë personin e lënduar në fatkeqësinë e komunikacionit në institucionin më të afërt shëndetësor.

Shoferi është i detyruar të veprojë në përputhje me dispozitat edhe para mbërritjes së nëpunësit policor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, përveç nëse fatkeqësia ka ndodhur në vendin ku mund të pres që ambulanca të arrijë shpejt ose nëse shoferi konkludon se në mënyrë joprofessionale dhe joadekuate të transportit, gjendja e personit të lënduar mund të përkeqësohet.

Në rast se institucioni shëndetësor njoftohet për fatkeqësinë e komunikacionit ose pranon për trajtim person të lënduar në fatkeqësi komunikacioni, është i detyruar të njoftojë për të menjëherë Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Në rast se personi i lënduar në fatkeqësi komunikacioni vdes nga lëndimet e marra brenda 30 ditëve, institucioni shëndetësor është i detyruar të informojë për të menjëherë Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Nëpunësit policorë të Ministrisë së Punëve të Brendshme janë të detyruar të shkojnë në vendin e fatkeqësisë së komunikacionit në të cilën ka persona të vdekur ose të lënduar ose ka ndodhur dëmtim i madh material dhe të hartojnë raport për të inspektuar.

Shoferi i pranishëm - pjesëmarrës në fatkeqësinë e komunikacionit - është i detyruar me kërkesë të pronarit të munguar me arsye, përkatësisht bartësit të së drejtës për të përdorur automjetin tjetër, t'ia paraqesë emrin, mbiemrin dhe adresën e vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimin.

Në rast se shoferi në fatkeqësi komunikacioni në të cilën ka ndodhur dëmtim i vogël material i automjetit tjetër, për shkak të mungesës së shoferit të automjetit tjetër, nuk është në gjendje t'i sigurojë të dhënat personale dhe të dhënat e sigurimit të automjetit, është i detyruar ta njoftojë Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe t'ia japë të dhënat e tij personale dhe të dhënat e automjetit të dëmtuar.

Shoferët, pjesëmarrës në fatkeqësinë e komunikacionit, në të cilën ka ndodhur dëmtim i vogël material, janë të detyruar, pasi të kenë plotësuar dhe nënshkruar Raportin Evropian të fatkeqësisë së komunikacionit, që menjëherë t'i heqin automjetet nga rruga dhe të mundësojnë rrjedhën e qetë të komunikacionit. (Foto. 152)



Fotografia 152

Shoferët, pjesëmarrës në fatkeqësinë e komunikacionit, në të cilën ka ndodhur dëmtim i vogël material, të cilët kanë plotësuar dhe nënshkruar Raportin Evropian të fatkeqësisë së komunikacionit, nuk janë të detyruar që për të ta njoftojnë Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Raporti Evropian i fatkeqësisë së komunikacionit nuk plotësohet dhe nënshkruhet në rast të fatkeqësisë së komunikacionit në të cilën ka persona të lënduar, persona të vdekur dhe ka ndodhur dëmtim i madh material. Raporti Evropian i fatkeqësisë së komunikacionit vë në dispozicion për pjesëmarrësit në fatkeqësinë e komunikacionit Byronë Nationale të Sigurimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Shoqëria e sigurimit, kur lidh kontratë për sigurimin e detyrueshëm (polisa), është e detyruar t'i lëshojë pronarit të automjetit Raport Evropian të fatkeqësisë së komunikacionit, në përputhje me modelin e raportit të lëshuar nga Komiteti Evropian i Sigurimit.

Nëpunësit policorë të Ministrisë së Punëve të Brendshme janë të detyruar të shkojnë në vendin e fatkeqësisë së komunikacionit, në të cilën ka ndodhur dëmtim i vogël material dhe të inspektojnë, nëse kërkohet nga njëri prej pjesëmarrësve në fatkeqësinë e komunikacionit, në rastet kur:

- njëri nga automjetet nuk ka targa ose nuk është i siguruar,
- njëri nga automjetet ka targa të huaja,
- njëri nga shoferët është nën ndikimin e alkoolit, drogës ose substancave të tjera psikotrope,
- njëri nga shoferët nuk ka patentë shoferi të kategorisë përkatëse,
- njëri nga shoferët ka sanksion të kundërvajtjes - ndalim për të ngasur mjet motorik në patentë shofer,
- njëri nga shoferët refuzon t'i japë të dhënat e tij personale, përkatësisht të dhënat e automjetit,
- njëri nga shoferët u largua nga vendi i fatkeqësisë së komunikacionit ose
- nëse shoferi vetë merr pjesë në fatkeqësi komunikacioni.

Personi i cili ka marrë pjesë në fatkeqësi komunikacioni nuk duhet të marrë pije alkoolike, droga dehëse, substanca psikotrope dhe barna që janë shënuar se nuk përdoren para dhe gjatë ngasjes derisa të bëhet inspektimi.

Nëpunësi policor i Ministrisë së Punëve të Brendshme i cili inspekton vendin e fatkeqësisë së komunikacionit, në të cilën ka persona të lënduar

ose dëmtim të madh material, do t'i nënshtrojë pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë në fatkeqësi komunikacioni për t'i marrë në pyetje me ndihmën e mjeteve dhe pajisjeve të përshtatshme ose do t'i dërgojë për kontroll profesional për të kontrolluar praninë e alkoolit, drogave dehëse, substancave psikotrope dhe barnave që tregohet se nuk përdoren para dhe gjatë ngasjes në organizëm. Në rast kur me marrjen në pyetje konstatohet se pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë në fatkeqësi komunikacioni kanë alkool, droga dehëse, substanca psikotrope dhe barna që janë të shënuara se ato nuk duhet të përdoren para dhe gjatë ngasjes në organizëm, nëpunësi policor i Ministrisë së Punëve të Brendshme që inspekton, do të vendos t'u merret gjak ose urinë për analiza.

Në rast kur në fatkeqësinë e komunikacionit ka persona të vdekur, nëpunësi policor i Ministrisë së Punëve të Brendshme që inspekton, do të vendos që pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë në fatkeqësi komunikacioni t'u merret gjak ose urinë për shkak të përcaktimit nëse janë nën ndikimin e alkoolit, drogave dehëse, substancave psikotrope dhe barnave që janë të shënuara se nuk duhet të përdoren para dhe gjatë ngasjes. Në këto raste, mjeku mund të vendosë që gjak dhe urinë mos të merren nëse do të kishte pasoja të dëmshme për shëndetin e pjesëmarrësve në fatkeqësi komunikacioni vetëm në gjendjen e rrezikshme për jetën e të lënduarit.

Nëpunësi policor i Ministrisë së Punëve të Brendshme i cili është duke inspektuar, është i detyruar të organizojë regjistrim të pasurisë së lënë në vendin e ngjarjes nga personi i cili ka vdekur në fatkeqësi komunikacioni ose është i lënduar rëndë, për të njoftuar personin juridik që heq automjete dhe sende nga rruga ose personi i interesuar dhe të ofrojë ndihmë për mbrojtjen e pasurisë, nëse nuk ka person në vendin e ngjarjes që mund ta marrë atë pasuri.

Në rastet e fatkeqësive të komunikacionit që marrin pjesë shtetas të huaj, automjeti me targa të huaja ose automjeti që transporton mallra që ndodhet në mbikëqyrje doganore, veprimet në lidhje me mbrojtjen e pasurisë dhe automjetin kryhen nga Drejtoria e Doganave.

Shoferi i cili me automjetin ka marrë pjesë në fatkeqësi komunikacioni në të cilën ka persona të lënduar ose të vdekur, si dhe personi tjetër i cili ka marrë pjesë drejtpërdrejt në fatkeqësinë e komunikacionit, kanë të drejtë të kërkojnë emrin dhe mbiemrin, adresën e vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimin, si dhe të dhëna të tjera të rëndësishme për fatkeqësinë e komunikacionit nga personat që ishin të pranishëm kur ndodhi fatkeqësia e komunikacionit.

Në rast se automjeti për shkak të fatkeqësisë së komunikacionit ose për shkak të defektit nuk mund të lëviz më tutje në rrugë, shoferi ose pronari, përkatësisht bartësi i së drejtës për të përdorur automjetin, është i detyruar nga rruga të heq menjëherë automjetin, ngarkesën, sendet ose materialin tjetër të shpërndarë. Në rast kur shoferi ose pronari, përkatësisht bartësi i së drejtës për të përdorur automjetin nuk është në gjendje të veprojë në përputhje me këtë dispozitë, nëpunësi policor i Ministrisë së Punëve të Brendshme, i cili do të gjendet në vendin e fatkeqësisë së komunikacionit

ose në rast të mosfunksionimit të automjetit, do t'i kërkojë personit juridik kompetent për mirëmbajtjen e rrugës në vend të sigurt nga rruga të heq automjetin, ngarkesën, sendet ose materialin tjetër të shpërndarë.

Personi juridik kompetent për mirëmbajtjen e rrugës është i detyruar me kërkesë të nëpunësit policor që urgjentisht t'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që nga rruga të heq dhe ruaj automjetin me ngarkesë, sendet ose materialin tjetër të shpërndarë dhe për të siguruar kalueshmërinë në rrugë.

Në rast se personi juridik kompetent për mirëmbajtjen e rrugës nuk vepron në përputhje me këtë dispozitë, ndërsa për shkak të mosfunksionimit të automjetit ose pengesave të krijuara në rrugë nga ngarkesa, sendet ose materiali tjetër, u pamundësohet lëvizja e pjesëmarrësve të tjerë në komunikacion, Ministria e Punëve të Brendshme do t'i ndërmarrë masat e tjera përkatëse për të mundësuar rrjedhën normale të komunikacionit.

SHKAQET MË TË ZAKONSHME TË FATKEQËSIVE NË KOMUNIKACION NË TË CILAT PËSOJNË SHOFRËT E RINJ, PËRKATËSISHT SHOFRËT FILLESTARË



Sipas të dhënave të OBSH-së, çdo vit rreth 400,000 të rinj në botë humbin jetën në fatkeqësi komunikacioni. Kjo do të thotë që 1,100 të rinj të moshën deri 25 vjeç humbin jetën çdo ditë në fatkeqësi komunikacioni në të gjithë botën. Fatkeqësitë e komunikacionit janë shkaku kryesor i vdekjes për personat e moshës prej 15 deri 19 vjeç, ndërsa shkaku i dytë i vdekjes për personat e moshës prej 10 deri 25 vjeç.

Duke i pasur parasysh faktet e mësipërme, me të drejtë mund të thuhet se fatkeqësitë e komunikacionit janë murtaja e zezë e shekullit 21.

Sipas përvojave botërore dhe rezultateve të hulumtimeve nga organizatat ndërkombëtare relevante, shkaqet më të zakonshme të fatkeqësive të komunikacionit në të cilat pësojnë shoferët fillestarë janë:

1. Papërvoja për të ngasur. Rreziku i shkaktimit të fatkeqësisë së komunikacionit është më i madh në vitin e parë pas marrjes së patentë shoferit. Prandaj, përkundër marrjes së patentë shoferit, rekomandohet që shoferët e rinj, përkatësisht shoferët fillestarë, të sigurojnë të paktën 30 deri në 50 orë praktikë të mbikëqyrur të ngasjes gjatë të paktën gjashtë muajve nga marrja e patentë shoferit. Praktika duhet të realizohet në rrugë të ndryshme, në kohë të ndryshme të ditës dhe në kushte të ndryshme të motit dhe kushteve të komunikacionit. Trajnimi praktik duhet të përfshijë edhe aktivitete për skanimin e vazhdueshëm të rreziqeve të mundshme në komunikacion, duke i përfshirë edhe automjetet e tjera, çiklistët dhe këmbësorët.

2. Pjekuria e pamjaftueshme dhe karakteri i dobët. Rreziku i shkaktimit të fatkeqësisë së komunikacionit rritet kur shoferët e rinj (shoferët fillestarë) ngasin pasagjerë të rinj në automjet. Sa më i madh është numri i pasagjerëve në automjet, aq më i madh është edhe rreziku. Prandaj, rekomandohet që shoferët e rinj (shoferët fillestarë) të ulin numrin e pasagjerëve të rinj në automjet në 0 ose një. Respektimi i këtij rekomandimi është veçanërisht i rëndësishëm në 6 muajt e parë pas marrjes së patentë shoferit.

3. Papërvoja në ngasjen e natës. Ngasja gjatë natës është rrezik për të gjithë shoferët. Fatkeqësitë fatale të komunikacionit zakonisht ndodhin në mbrëmje, por rreziku është shumë më i lartë për shoferët e rinj dhe papërvojë, përkatësisht për shoferët fillestarë. Sipas LSKRR-së, shoferët e rinj - shoferët fillestarë, nuk duhen të ngasin nga ora 23:00 deri në orën 5:00

të mëngjesit, në dy vitet e para pas marrjes së patentë shoferit, të pashoqëruar nga një i rritur mbi 25 vjeç i cili ka patentë shoferi të kategorisë përkatëse dhe të cilit nuk i është shqiptuar ndalimi i ngasjes së mjetit motorik.

Kjo është arsyeja pse mesazhi për shoferët e rinj, për shoferët fillestarë, është t'i respektojnë kufizimet ligjore dhe të praktikojnë ngasjen gjatë natës të shoqëruar nga shoferi me përvojë në mbrëmje, para se të fillojnë të ngasin në mënyrë të pavarur gjatë natës.

4. Mospërdorimi i rripit të sigurimit. Parandalimi themelor i vdekjeve në fatkeqësi komunikacioni është përdorimi i rripit të sigurimit. Hulumtimet tregojnë se shoferët e rinj - shoferët fillestarë dhe pasagjerët përdorin më pak rripin e sigurimit. Prandaj, gjithmonë përdorni rrip të sigurimit dhe kërkoni nga pasagjerët tuaj, që detyrimisht, të përdorin gjithmonë rrip të sigurimit në çdo udhëtim. Ky është hapi themelor për të zvogëluar rrezikun që të rinjtë të lëndohen rëndë në fatkeqësi komunikacioni.

5. Ngasja e pavëmendshme dhe e shpërqendruar. Shpërqendrimi, pakujdesia, pavëmendshmëria - e rrisin rrezikun të çdo shofer, dhe veçanërisht të shoferi fillestar, të shkaktojë fatkeqësi komunikacioni. Hulumtimet konfirmojnë se shoferët e rinj - shoferët fillestarë shpesh përdorin celular dhe ngasin të shpërqendruar. Në pajtim me të, këshillat për këtë kategori të shoferëve janë: Mos ndërmerrni aktivitete të cilat do t'ju shpërqendrojnë gjatë ngasjes, të tilla si biseda në celular, dërgimi i mesazheve, ngrënia ose loja në radio. Pasojat e ngasjes së shpërqendruar dhe të pavëmendshme shpesh janë fatale.

6. Lodhja. Shoferët e rinj - shoferët fillestarë, janë në rrezik të lartë të përgjumjes gjatë ngasjes, gjë që është shkak i mijëra fatkeqësive të komunikacionit çdo vjet. Të rinjtë janë më të përgjumur në orët e mëngjesit ose natën vonë. Prandaj, planifikojeni udhëtimin tuaj, udhëtoni të përgatitur, të pushuar, bëni më shumë pushime dhe konsumoni më shumë lëngje gjatë ngasjes. Asnjëherë mos vendosni qëllime të mëdha, mos i mbivlerësoni aftësitë tuaja dhe mos e nënvlerësoni lodhjen.

7. Ngasja e pandërgjegjshme. Hulumtimet tregojnë se të rinjve u mungon përvoja e gjykimit dhe pjekurisë së duhur për t'i vlerësuar situatat e rrezikshme. Të rinjtë janë më të prirur për të ndërmarrë rrezik, më pak mbajnë distancë të sigurt midis automjeteve, parakalojnë në mënyrë të gabuar, më pak janë të durueshëm dhe më pak janë tolerant në komunikacion. Për situata më pak të padëshiruara në rrugë, shoferët e rinj - shoferët fillestarë duhet të jenë shoferë të ndërgjegjshëm dhe të përgjegjshëm dhe gjithmonë t'i respektojnë rregullat e komunikacionit.

8. Ngasja e shpejtë dhe alkooli. Shpejtësia dhe alkooli bëjnë gabime që shpesh përfundojnë me pasoja fatale. Shoferi fillestar nuk duhet të ngasë automjetin me shpejtësi më të madhe se 60 km / orë në rrugë publike, përkatësisht me shpejtësi më të madhe se 80 km / orë në rrugë të destinuar ekskluzivisht për qarkullimin e mjeteve motorike, përkatësisht me shpejtësi më të madhe se 100 km / orë në autostradë.

Shoferi fillestar që ka patentë shoferi të kategorisë "B" nuk duhet të ngasë automjetin me fuqi motorike më të madhe se 77 kilovat. Toleranca, respektivisht sasia e lejuar e alkoolit në gjakun e shoferit fillestar është e barabartë me zero.

Ngasja e shpejtë dhe alkooli janë shkaqet më të zakonshme të fatkeqësive të komunikacionit me pasoja fatale. Prandaj, respektoni rregullat e kufizimit të shpejtësisë dhe kurrë mos ngisni nën ndikimin e alkoolit.

KRSKRR-ja me thirrje:

**SIGURIA NË KOMUNIKACION KËRKON SERIOZITET,
PËRGJEGJËSI DHE RESPEKTIM MAKSIMAL TË
RREGULLAVE TË KOMUNIKACIONIT. RINIA DHE FAKTI
QË JENI SHOFER FILLESTAR, NUK ËSHTË DHE NUK
MUND TË JETË KURRFARË JUSTIFIKIMI PËR SJELLJEN E
PAPËRGJEGJSHME NË KOMUNIKACION.**

JI SHOFER I PËRGJEGJSHËM! #NGASMEPËRGJEGJËSI!

SHENJAT E KOMUNIKACIONIT

	101 - rreziku në rrugë
	102 - kryqëzimi i rrugës me rëndësi të njëjtë
	103.1 - kthesë në të majtë
	103.2 - kthesë në të djathtë
	104.1 - kthesë e dyfishtë ose kthesa të shumta radhazi, e para prej të cilave është në të majtë
	104.2 - kthesë e dyfishtë ose kthesa të shumta radhazi, e para prej të cilave është në të djathtë
	105 - kryqëzimi me rrugë dytësore me kënd të drejtë
	105.1 - bashkimi me rrugë dytësore me kënd të drejtë në anën e majtë

	105.2 - bashkimi me rrugë dytësore me kënd të drejtë në anën e djathtë
	105.3 - bashkimi me rrugë dytësore me kënd të drejtë në anën e majtë dhe të djathtë
	105.4 - bashkimi me rrugë dytësore me kënd të drejtë në anën e majtë dhe të djathtë
	105.5 - bashkimi me rrugë dytësore me kënd të mprehtë në anën e majtë
	105.6 - bashkimi me rrugë dytësore me kënd të mprehtë në anën e djathtë
	105.7 - bashkimi me rrugë dytësore me kënd të mprehtë në anën e majtë
	105.8 - bashkimi me rrugë dytësore me kënd të mprehtë në anën e djathtë
	106 - tatëpjetë e rrezikshme
	107 - përpjetë e rrezikshme

	108 - rrugë e parrafshët
	108.1 - rrugë e parrafshët (gungë)
	108.2 - rrugë e parrafshët (gropësirë)
	109 - rreziku nga akulli
	110 - rrugë e rrëshqitshme
	111.1 - rrëshqitje dheu e gurëve në anën e djathtë
	111.1 - rrëshqitje dheu e gurëve në anën e majtë
	112 - thyerje e gurëve
	113.1 - frymë anësore nga ana e djathtë









	113.2 - frymë anësore nga ana e majtë
	114 - ngushtimi i rrugës
	114.1 - ngushtimi i rrugës në anën e djathtë
	114.2 - ngushtimi i rrugës në anën e majtë
	115 - punime në rrugë
	116 - komunikacioni i dendur
	117 - bashkimi i dy rrugëve me komunikacion me një drejtim në rrugë me komunikacion me dy drejtime
	118 - komunikacioni në dy drejtime
	119 - urë lëvizëse

	120 - afër bregut
	121.1 - ndeshja e shenjave të komunikacionit me dritë
	121.2 - ndeshja e shenjave të komunikacionit me dritë
	122 - këmbësorët në rrugë
	123 - vendkalimi i shënuar për këmbësorë
	124 - fëmijët në rrugë
	125 - çiklistët në rrugë
	126 - kafshët në rrugë
	126.1 - kafshët në rrugë

	127 - kafshët e egra në rrugë
	127.1 - kafshët e egra në rrugë
	127.2 - bretkosat në rrugë
	128 - afër pistës së aviacionit
	129 - afër stacionit të autobusit
	130 - linja e tramvajit
	131 - kryqëzimi me rrethrotullimin e komunikacionit
	132 - përmbysja ose rrëshqitja e automjeteve
	133 - trotuari i pakonstatuar

	134 - tuneli (galeria)
	135 - rreziku nga zjarri
	136 - kalimi i rrugës përmes vijës hekurudhore me parakolp ose gjysmëparakolp
	137 - kalimi i rrugës përmes vijës hekurudhore pa parakolp ose gjysmëparakolp
	138 - Kryqi i Andreit - kalimi i rrugës përmes vijës hekurudhore në nivel pa parakolp ose gjysmëparakolp me një binar
	139 - Kryqi i Andreit - kalimi i rrugës përmes vijës hekurudhore në nivel pa parakolp ose gjysmëparakolp me dy ose me më shumë binarë
	140 - kalimi i rrugës dytësore përmes vijës hekurudhore me parakolp ose gjysmëparakolp
	140.1 - kalimi i rrugës dytësore përmes vijës hekurudhore me parakolp ose gjysmëparakolp
	141 - kalimi i rrugës dytësore përmes vijës hekurudhore pa parakolp ose gjysmëparakolp
	141.1 - kalimi i rrugës dytësore përmes vijës hekurudhore pa parakolp ose gjysmëparakolp









	<p>142, 142.1, 142.2 - afrimi në kalimin e rrugës përmes vijës hekurudhore pa parakolp ose gjysmëparakolp</p>
	<p>143 - fatkeqësia në komunikacion</p>
	<p>144 - rreziku i shfaqjes së mjegullës në rrugë</p>
	<p>145 - automjeti në drejtim të kundërt</p>
	<p>201 - kryqëzimi me rrugën me përparësi kalimi</p>
	<p>202 - ndalimi i detyrueshëm</p>
	<p>203 - përparësia e kalimit për automjetet nga drejtimi i kundërt</p>
	<p>204 - ndalimi i komunikacionit në të dyja drejtimet</p>

	<p>205 - ndalimi i komunikacionit në një drejtim</p>
	<p>206 - ndalimi i komunikacionit për të gjitha mjetet me fuqi motorike, përveç motoçikletave pa rimorkio dhe mopedëve</p>
	<p>207 - ndalimi i komunikacionit për autobusë</p>
	<p>208 - ndalimi i komunikacionit për mjetet transportuese</p>
	<p>209 - ndalimi i komunikacionit për cisterna</p>
	<p>210 - ndalimi i komunikacionit për mjetet që transportojnë eksplozivë ose disa materie të ndezshme</p>
	<p>211 - ndalimi i komunikacionit për mjetet që transportojnë materie të rrezikshme</p>
	<p>212 - ndalimi i komunikacionit për mjetet me fuqi motorike që tërheqin rimorkio, përveç gjysmërimorkios</p>

	<p>213 - ndalimi i komunikacionit për të gjitha mjetet me fuqi motorike që tërheqin rimorkio, përveç rimorkios së lehtë ose kamp-rimorkios</p>
	<p>213.1 - ndalimi i komunikacionit për të gjitha mjetet me fuqi motorike që tërheqin rimorkio</p>
	<p>214 - ndalimi i komunikacionit për traktorë</p>
	<p>215 - ndalimi i komunikacionit për motoçikleta</p>
	<p>216 - ndalimi i komunikacionit për mopedë</p>
	<p>216 - ndalimi i komunikacionit për biçikleta</p>
	<p>218 - ndalimi i komunikacionit për mjete mbrehëse</p>
	<p>219 - ndalimi i komunikacionit për kalorës</p>

	<p>220 - ndalimi i komunikacionit për karrocë dore</p>
	<p>221 - ndalimi i komunikacionit për këmbësorë</p>
	<p>222 - ndalimi i komunikacionit për të gjitha mjetet me fuqi motorike</p>
	<p>223 - ndalimi i komunikacionit për të gjitha mjetet me fuqi motorike dhe mjetet mbrehëse</p>
	<p>224 - ndalimi i komunikacionit për mjetet, gjerësia e përgjithshme e të cilave e tejkalon gjerësinë e caktuar</p>
	<p>225 - ndalimi i komunikacionit për mjetet, lartësia e përgjithshme e të cilave e tejkalon lartësinë e caktuar</p>
	<p>226 - ndalimi i komunikacionit për mjetet, masa e përgjithshme e të cilave e tejkalon masën e caktuar</p>
	<p>227 - ndalimi i komunikacionit për mjetet që e tejkalojnë ngarkesën e caktuar të boshtit</p>

	<p>228 - ndalimi i komunikacionit për mjetet që e tejkalojnë gjatësinë e caktuar</p>
	<p>229 - distanca më e shkurtër midis automjeteve</p>
	<p>230 - ndalimi i kthimit në të majtë</p>
	<p>231 - ndalimi i kthimit në të djathtë</p>
	<p>232 - ndalimi i kthimit gjysmërrethor</p>
	<p>233 - ndalimi i parakalimit të të gjitha mjeteve me fuqi motorike, përveç motoçikletave pa rimorkio dhe mopedëve</p>
	<p>234 - ndalimi i parakalimit për mjetet transportuese</p>
	<p>235 - kufizimi i shpejtësisë</p>

	235.1 - kufizimi i shpejtësisë
	235.2 - kufizimi i shpejtësisë
	235.3 - kufizimi i shpejtësisë
	235.4 - kufizimi i shpejtësisë
	235.5 - kufizimi i shpejtësisë
	235.6 - kufizimi i shpejtësisë
	235.7 - kufizimi i shpejtësisë
	235.8 - kufizimi i shpejtësisë




	235.9 - kufizimi i shpejtësisë
	235.10 - kufizimi i shpejtësisë
	235.11 - kufizimi i shpejtësisë
	235.12 - kufizimi i shpejtësisë
	236 - ndalimi për t'u ndaluar dhe parkuar
	237 - ndalimi për t'u parkuar
	238 - parkimi i ndërsjellë
	239 - parkimi i ndërsjellë
	240 - ndalimi i kalimit pa u ndalur - dogana

	<p>241 - ndalimi i kalimit pa u ndalur - policia</p>
	<p>242 - ndalimi i kalimit pa u ndalur - pikëpagesa rrugore</p>
	<p>243 - ndalimi i dhënies së shenjave të zëshme</p>
	<p>244 - ndalimi i të fotografuarit</p>
	<p>245 - drejtimi i detyrueshëm</p>
	<p>245.1 - drejtimi i detyrueshëm</p>
	<p>245.2 - drejtimi i detyrueshëm</p>
	<p>245.3 - drejtimi i detyrueshëm</p>
	<p>245.4 - drejtimi i detyrueshëm</p>

	245.5 - drejtimi i detyrueshëm
	246.1 - drejtime të lejuara
	246.2 - drejtime të lejuara
	246.3 - drejtime të lejuara
	247 - rrethrotullimi në komunikacion
	248.1 - kalimi i detyrueshëm në anën e majtë
	248.2 - kalimi i detyrueshëm në anën e djathtë
	249 - shtegu i çiklistëve
	250 - shtegu i kalorësve

	251 - shtegu i këmbësorëve
	252 - shtegu i veçuar për çiklistët dhe këmbësorët
	253 - shtegu për çiklistët dhe këmbësorët
	254 - pajisja dimërore (zinxhirë bore)
	255 - shpejtësia më e vogël e lejuar

SHENJAT E NJOFTIMIT






	301 - përparësia e kalimit në lidhje me automjetet nga drejtimi i kundërt
	302.1 - vendkalimi i shënuar për këmbësorë
	302.2 - vendkalimi i shënuar për biçikleta








	<p>302.3 - vendkalimi i kombinuar dhe i shënuar për këmbësorë dhe për biçikleta</p>
	<p>302.4 - vendkalimi i kombinuar dhe i shënuar për këmbësorë dhe për biçikleta</p>
	<p>303 - fëmijët në rrugë</p>
	<p>304 - vendkalimi nëntokësor ose mbitokësor për këmbësorë</p>
	<p>304.1 - vendkalimi nëntokësor ose mbitokësor për këmbësorë</p>
	<p>305 - rrugë me një drejtim</p>
	<p>305.1 - rrugë me një drejtim</p>
	<p>305.2 - rrugë me një drejtim</p>
	<p>306 - rrugë me përparësi kalimi</p>





	<p>307 - fundi i rrugës me përparësi kalimi</p>
	<p>308 - ndërprerja e kufizimit të shpejtësisë</p>
	<p>309 - ndërprerja e shpejtësisë më të vogël të lejuar</p>
	<p>310 - ndërprerja e ndalimit të parakalimit të të gjitha mjeteve me fuqi motorike, përveç mopedëve</p>
	<p>311 - ndërprerja e ndalimit të parakalimit të mjeteve transportuese</p>
	<p>312 - ndërprerja e ndalimit të dhënies së shenjave të zëshme</p>
	<p>313 - ndërprerja e të gjitha ndalimeve</p>
	<p>314.1 - fundi i shtegut të biçikletave</p>







	<p>314.2 - fundi i shtegut të kalorësve</p>
	<p>314.3 - fundi i shtegut të këmbësorëve</p>
	<p>314.4 - fundi i shtegut të veçuar për çiklistët dhe këmbësorët</p>
	<p>314.5 - fundi i shtegut për çiklistët dhe këmbësorët</p>
	<p>314.6 - ndërprerja e obligimit për përdorimin e pajisjeve dimërore</p>
	<p>315.1 - zona në të cilën kufizohet shpejtësia</p>
	<p>315.2 - fundi i zonës në të cilën kufizohet shpejtësia</p>
	<p>316.1 - zona e këmbësorëve</p>







	<p>316.2 - fundi i zonës së këmbësorëve</p>
	<p>317.1 - zona në të cilën parkimi është i ndaluar</p>
	<p>317.2 - fundi i zonës në të cilën parkimi është i ndaluar</p>
	<p>317.3 - zona me emisione të ulëta të gazrave të dëmshme</p>
	<p>317.4 - fundi i zonës me emisione të ulëta të gazrave të dëmshme</p>
	<p>318.1 - zona e komunikacionit të qetë</p>
	<p>318.2 - fundi i zonës së komunikacionit të qetë</p>
	<p>318.3 - zona e shkollës</p>







	<p>318.4 - fundi i zonës së shkollës</p>
	<p>318.5 - zona në të cilën lejohet parkimi</p>
	<p>318.6 - zona në të cilën kohëzgjatja e parkimit është e kufizuar</p>
	<p>318.7 - fundi i zonës në të cilën lejohet parkimi</p>
	<p>318.8 - fundi i zonës në të cilën kohëzgjatja e parkimit është e kufizuar</p>
	<p>318.9 - shtegu për automjetet e ndërhyrjes</p>
	<p>318.10 - kalimi për automjetet e ndërhyrjes</p>







	<p>319.1 - shpejtësia e rekomanduar</p>
	<p>319.2 - ndërprerja e shpejtësisë së rekomanduar</p>
	<p>320 - gungë në rrugës</p>
	<p>321 - kalimi i lejuar</p>
	<p>322 - patrulla e shkollës</p>
	<p>323 - spitali</p>
	<p>324 - stacioni i ndihmës së parë</p>








	<p>325.1 - vendparkimi</p>
	<p>325.2 - garazhi</p>
	<p>325.3 - kufizimi kohor i parkimit</p>
	<p>326 - punëtoria për riparimin e automjeteve</p>
	<p>327 - telefoni për thirrje në raste urgjente</p>
	<p>328 - stacioni i furnizimit me karburant</p>
	<p>328.1 - stacioni i furnizimit me karburant (LPG, CMG, LNG, H2)</p>

	<p>329 - uji i pijshëm</p>
	<p>330 - stacioni i autobusit</p>
	<p>331 - stacioni i tramvajit</p>
	<p>332 - informacioni</p>
	<p>333 - ndihma në rrugë</p>
	<p>334 - aeroporti</p>









	<p>335 - marina</p>
	<p>336 - terreni i rregulluar për piknik</p>
	<p>337.1 - terreni për të kampuar në çadra</p>
	<p>337.2 - terreni për të kampuar në rimorkio</p>
	<p>337.3 - terreni për të kampuar në automjete</p>
	<p>338 - shtëpia e bjeshkatarëve</p>

	<p>339 - shërbimi i zjarrfikësve</p>
	<p>340 - mjete për të ofruar ndihmë në rrugë</p>
	<p>341 - hoteli ose moteli</p>
	<p>342 - restoranti</p>
	<p>343 - kafeneja</p>
	<p>344 - tualeti</p>









	345 - autolarja
	346 - stacioni policor - POLICIA
	347 - taksi
	348 - porti
	348.1 - anija
	349 - radiostacioni









	<p>350 - zona e ujërave të mbrojtura</p>
	<p>351 - autostrada</p>
	<p>351.1 - fundi i autostradës</p>
	<p>352 - rrugë ekspres</p>
	<p>352.1 - fundi i rrugës ekspres</p>
	<p>353 - rrugë e rezervuar për qarkullimin e mjeteve motorike</p>
	<p>353.1 - fundi i rrugës së rezervuar për qarkullimin e mjeteve motorike</p>









	354 - rrugë e verbër
	354.1 - rrugë e verbër
	354.2 - rrugë e verbër
	354.3 - rrugë e verbër
	354.4 - rrugë e verbër
	354.5 - rrugë e verbër
	354.6 - rrugë e verbër, përveç për këmbësorë
	354.7 - rrugë e verbër, përveç për këmbësorë dhe biçikleta


	<p>355 - drejtimi i lëvizjes së automjeteve që kanë për qëllim të kthejnë në të majtë në udhëkryq ku ndalohehet kthimi në të majtë</p>
	<p>356 - zgjerimi për ndalimin e detyruar të automjeteve me telefonin "SOS"</p>
	<p>356.1 - zgjerimi për ndalimin e detyruar të automjeteve pa telefonin "SOS"</p>
	<p>357 - lumi</p>
	<p>358 - objekti rrugor (tuneli)</p>
	<p>358.1 - objekti rrugor (viadukti)</p>
	<p>359 - qafë mali</p>
	<p>360 - emri i vendbanimit</p>







	360.1 - vendbanimi
	361 - fundi i vendbanimit
	361.1 - fundi i vendbanimit, fillon vendbanimi tjetër
	362 - udhërrëfyesi
	362.1 - udhërrëfyesi
	363 - udhërrëfyesi i aeroportit
	364 - udhërrëfyesi i unazës së përkohshme
	364.1 - udhërrëfyesi i unazës së përkohshme për këmbësorë
	364.2 - udhërrëfyesi i unazës së përkohshme për lloje të caktuara të automjeteve
	365 - rirreshtimi i automjeteve në udhëkryq
	365.1 - rirreshtimi i automjeteve në udhëkryq ku lejohen drejtime të caktuara vetëm për lloje të caktuara të automjeteve







	<p>365.2 - rirreshtimi i automjeteve në udhëkryq me zonë pritjeje për çiklistët</p>
	<p>365.3 - rirreshtimi i automjeteve në udhëkryq rrethor</p>
	<p>365.4 - rirreshtimi i automjeteve në udhëkryq rrethor</p>
	<p>365.5 - rirreshtimi i automjeteve në udhëkryq me korsitë e rezervuara për lloje të caktuara të transportit</p>
	<p>365.6 - rirreshtimi i automjeteve në udhëkryq me korsitë e rezervuara për lloje të caktuara të transportit</p>
	<p>365.7 - rirreshtimi i automjeteve me emrin e vendbanimeve</p>
	<p>366 - shenja e unazës</p>
	<p>367 - korsa e komunikacionit për mjetet e transportit publik të pasagjerëve</p>







	<p>367.1 - korsia e komunikacionit për mjetet e transportit publik të pasagjerëve</p>
	<p>367.2 - korsia e komunikacionit për mjetet e transportit publik të pasagjerëve</p>
	<p>367.3 - korsia e komunikacionit për mjetet e transportit publik të pasagjerëve</p>
	<p>367.4 - korsia e komunikacionit për mjetet e transportit publik të pasagjerëve</p>
	<p>367.5 - korsia e komunikacionit për mjetet e transportit publik të pasagjerëve</p>
	<p>367.6 - korsia e komunikacionit për mjetet e transportit publik të pasagjerëve</p>
	<p>367.7 - korsia e komunikacionit për mjetet e transportit publik të pasagjerëve</p>
	<p>367.8 - korsia e komunikacionit për mjetet e transportit publik të pasagjerëve</p>








	<p>367.9 - korsia e komunikacionit për mjetet e transportit publik të pasagjerëve</p>
	<p>367.10 - korsia e komunikacionit për mjetet e transportit publik të pasagjerëve</p>
	<p>367.11 - korsia e komunikacionit për mjetet e transportit publik të pasagjerëve</p>
	<p>367.12 - korsia e komunikacionit për mjetet e transportit publik të pasagjerëve</p>
	<p>367.13 - korsia e komunikacionit për mjetet e transportit publik të pasagjerëve</p>
	<p>367.14 - korsia e komunikacionit për mjetet e transportit publik të pasagjerëve</p>
	<p>367.15 - korsia e komunikacionit për mjetet e transportit publik të pasagjerëve</p>
	<p>368 - korsia e komunikacionit për mjetet e ngadalshme</p>

	<p>368.1 - fundi i korsisë së komunikacionit për mjetet e ngadalshme</p>
	<p>369 - shpejtësia e lejuar e korsisë së veçantë të komunikacionit</p>
	<p>370 - kufizimi i shpejtësisë maksimale të lejuar në rrugët në Republikën e Maqedonisë së Veriut</p>
	<p>371 - Republika e Maqedonisë së Veriut</p>
	<p>372 - fike motorin</p>
	<p>373 - tabela për të shënuar emrin e rrugës</p>
	<p>374 - stacioni policor</p>










	<p>375 - drejtimi i detyrueshëm, përkatësisht drejtimet e lejuara për lloje të caktuara të mjeteve</p>
	<p>375.1 - drejtimi i detyrueshëm, përkatësisht drejtimet e lejuara për lloje të caktuara të mjeteve</p>
	<p>375.2 - drejtimi i detyrueshëm, përkatësisht drejtimet e lejuara për lloje të caktuara të mjeteve</p>
	<p>375.3 - drejtimi i detyrueshëm, përkatësisht drejtimet e lejuara për lloje të caktuara të mjeteve</p>
	<p>375.4 - drejtimi i detyrueshëm, përkatësisht drejtimet e lejuara për lloje të caktuara të mjeteve</p>
	<p>375.5 - drejtimi i detyrueshëm, përkatësisht drejtimet e lejuara për lloje të caktuara të mjeteve</p>

	<p>375.6 - drejtimi i detyrueshëm, përkatësisht drejtimet e lejuara për lloje të caktuara të mjeteve</p>
	<p>375.7 - drejtimi i detyrueshëm, përkatësisht drejtimet e lejuara për mjetet që transportojnë materie të rrezikshme</p>
	<p>375.8 - drejtimi i detyrueshëm, përkatësisht drejtimet e lejuara për mjetet që transportojnë materie të rrezikshme</p>
	<p>375.9 - drejtimi i detyrueshëm, përkatësisht drejtimet e lejuara për mjetet që transportojnë materie të rrezikshme</p>
	<p>375.10 - drejtimi i detyrueshëm, përkatësisht drejtimet e lejuara për mjetet që transportojnë materie të rrezikshme</p>
	<p>375.11 - drejtimi i detyrueshëm, përkatësisht drejtimet e lejuara për mjetet që transportojnë materie të rrezikshme</p>









	<p>375.12 - drejtimi i detyrueshëm, përkatësisht drejtimet e lejuara për mjetet që transportojnë materie të rrezikshme</p>
	<p>375.13 - drejtimi i detyrueshëm, përkatësisht drejtimet e lejuara për mjetet që transportojnë materie të rrezikshme</p>
	<p>376 - korsia e komunikacionit e destinuar për lloj të caktuar të mjeteve</p>
	<p>376.1 - korsia e komunikacionit e destinuar për lloj të caktuar të mjeteve</p>
	<p>376.2 - korsia e komunikacionit e destinuar për lloj të caktuar të mjeteve</p>
	<p>376.3 - korsia e komunikacionit e destinuar për lloj të caktuar të mjeteve</p>








	<p>376.4 - korsia e komunikacionit e destinuar për lloj të caktuar të mjeteve</p>
	<p>376.5 - korsia e komunikacionit e destinuar për lloj të caktuar të mjeteve</p>
	<p>377 - shenja për rregullimin me dorë të komunikacionit</p>
	<p>378 - zona e lëvizjes së shpeshtë të personave të verbër</p>
	<p>378.1 - fundi i zonës së lëvizjes së shpeshtë të personave të verbër</p>
	<p>379 - riorientimi i komunikacionit në rrugë tjetër</p>
	<p>379.1 - riorientimi i komunikacionit në rrugë tjetër</p>







	<p>379.2 - riorientimi i komunikacionit në rrugë tjetër</p>
	<p>380 - shenja për mbylljen e korsisë së komunikacionit</p>
	<p>380.1 - shenja për mbylljen e korsisë së komunikacionit</p>
	<p>380.2 - shenja për mbylljen e korsisë së komunikacionit</p>
	<p>380.3 - shenja për mbylljen e korsisë së komunikacionit</p>
	<p>380.4 - shenja për mbylljen e korsisë së komunikacionit</p>
	<p>380.5 - shenja për mbylljen e korsisë së komunikacionit</p>
	<p>381 - shenja për riorientimin e komunikacionit në rrugë me korsitë të ndara</p>

	<p>381.1 - shenja për riorientimin e komunikacionit në rrugë me kors të ndara</p>
	<p>381.2 - shenja për riorientimin e komunikacionit në rrugë me kors të ndara</p>
	<p>381.3 - shenja për riorientimin e komunikacionit në rrugë me kors të ndara</p>
	<p>381.4 - shenja për riorientimin e komunikacionit në rrugë me kors të ndara</p>
	<p>381.5 - shenja për riorientimin e komunikacionit në rrugë me kors të ndara</p>
	<p>382.1 - numri i rrugës ndërkombëtare</p>
	<p>382.2 - numri i autostradës</p>
	<p>382.3 - numri i rrugës ekspres, rrugës magjistrale dhe rrugës së rezervuar vetëm për mjetet motorike</p>
	<p>382.4 - numri i rrugës rajonale</p>

	<p>382.5 - shenja e segmentit të rrugës magjistrale</p>
	<p>382.6 - shenja e segmentit të rrugës rajonale</p>
	<p>382.7 - shenja kilometrëshe e autostradës</p>
	<p>382.8 - shenja e daljes nga autostrada</p>
	<p>382.9 - shenja e nyjave në autostradë</p>
	<p>382.10 - shenja e numrit të daljes ose nyjës</p>
	<p>383, 383.1, 383.2 - dalja nga autostrada</p>
	<p>383.3, 383.4, 383.5 - dalja nga rruga ekspres ose nga rruga e rezervuar për komunikacionin e mjeteve motorike</p>
	<p>384 - mënyra e përdorimit të korsisë së komunikacionit</p>

	<p>385 - lëshimi i ndërsjellë i automjeteve</p>
	<p>386.1 - dalja në rast rreziku</p>
	<p>386.2 - dalja në rast rreziku</p>
	<p>387.1 - largësia e daljes në rast rreziku</p>
	<p>387.2 - largësia e daljes në rast rreziku</p>
	<p>388 - autoshenja nacionale në shenjat e komunikacionit</p>
	<p>389 - mos e bllokoni udhëkryqin</p>
	<p>390 - komunikacioni është nën video-mbikëqyrje</p>

	<p>391 - puth dhe ngas</p>
	<p>392 - parko dhe ngas</p>
	<p>392.1 - parko dhe ngas</p>
	<p>393 - pajisja e karikimit të automjeteve elektrike</p>
	<p>394 - kontrollimi i shpejtësisë</p>
	<p>395 - tabela udhërrëfyese e çiklistëve</p>
	<p>396 - udhërrëfyese i çiklistëve</p>

	<p>396.1 - udhërrëfyese i çiklistëve</p>
	<p>397 - numri i lidhjes së biçikletave</p>
	<p>397.1 - numri i lidhjes së biçikletave</p>
	<p>398 - pajisja për parandalimin e lëvizjes së mëtejshme</p>
	<p>399 - informacioni mbi punimet ndërtimore në rrugë</p>
	<p>400 - tabela udhërrëfyese e vendparkimit ose garazhit në kate me informacionet mbi numrin e vendeve të lira të parkimit</p>

KONKLUZIONI:

Të nderuar shoferë fillestarë!

Konsiderojmë se "Doracaku për shofer fillestar", do të jetë i dobishëm për ju që t'i zotëroni dhe mësoni lehtësisht rregullat e komunikacionit, t'i mësoni shenjat e komunikacionit dhe t'i zotëroni lehtësisht teknikat dhe aftësitë e ngasjes së mjetit motorik dhe t'i sqaroni të gjitha momentet e paqarta, situatat e komunikacionit, gjendjet dhe detajet e veçanta që hasen zakonisht nga çdo shofer fillestar.

Lexojeni doracakun me kujdes dhe analizojeni plotësisht. Sigurohuni që i keni kuptuar dhe i keni mësuar plotësisht të gjitha rregullat e komunikacionit. Për të gjitha çështjet e paqarta, konsultohuni me KRSKRR-në përmes faqes së internetit të KRSKRR-së www.rsbp.org.mk, më saktësisht përmes postës elektronike: contact@rsbp.org.mk.

Pasojat e fatkeqësive në komunikacion janë shumë serioze për ta lejuar veten që të papërgatitur dhe të edukuar jo aq sa duhet për të marrë pjesë në komunikacion. Fatkeqësitë e komunikacionit u ndodhin të gjithëve, kudo dhe kur më pak e prisni, ndërsa pasojat e fatkeqësive të komunikacionit janë humbja e jetëve njerëzore, shumë persona të lënduar dhe dëmtime dhe humbje të mëdha materiale.

Me çdo pjesëmarrje të papërgjegjshme në komunikacion, ju e rrezikoni jetën tuaj, jetën dhe shëndetin e të dashurve tuaj, por edhe jetën dhe shëndetin e të gjithë pjesëmarrësve të tjerë në komunikacion. Përgjegjësia ligjore dhe morale bartet për çdo dëm apo jetë të rrezikuar.

Komunikacioni nuk është lojë. Në komunikacion nuk ka vend për shoferët pa patentë shoferi, por nuk ka vend as për shoferët të cilët për shkak të mosdijes ose papërgjegjësisë i shkelin rregullat e komunikacionit dhe kështu e rrezikojnë sigurinë e tij.

Përveç për shoferët fillestarë, doracaku është i përshtatshëm dhe i dobishëm për t'u përdorur nga kandidatët për shoferë që do të japin provimin për ngasjen e automjetit, por është i përshtatshëm për t'u përdorur edhe nga ata shoferë që tashmë kanë patentë shoferi për një periudhë më të gjatë. Qëllimi është t'i përkujtojë ata dhe t'i edukojë në mënyrë plotësuese mbi rregullat e komunikacionit dhe risitë në komunikacion që imponohen çdo ditë si rezultat i rritjes së vazhdueshme të dinamikës, vëllimit dhe intensitetit të komunikacionit.

Provimi i ngasjes së automjetit jepet një herë, patentë shoferi merret një herë, ndërsa ju jeni pjesëmarrës në komunikacion gjithë jetën tuaj. Prandaj, edukimi i vazhdueshëm, përsëritja dhe rinovimi i njohurive tuaja është i domosdoshëm.

"Doracaku për shoferët fillestarë" në përmbajtjen e tij i përfshin dispozitat më të rëndësishme të Ligjit për siguri në komunikacionin rrugor të cilat e rregullojnë komunikacionin rrugor, përkatësisht rregullat më të rëndësishme dhe dispozitat ligjore që shoferët duhet t'i dinë dhe t'i respektojnë.

Qëllimi i KRSKRR-së, përkatësisht qëllimi për të cilin është përgatitur doracaku është përmes shembujve konkretë, fotografive dhe dispozitave ligjore të përcaktuara saktësisht, për t'ju drejtuar që të merrni pjesë në mënyrë të duhur dhe të sigurt në komunikacion dhe të jeni pjesëmarrës të përgjegjshëm në komunikacion, për t'i parë realisht gabimet që nganjëherë i bëni në mënyrë të pavetëdijshme dhe t'ju udhëzojmë se si t'i korrigjoni ato dhe të jeni shembull për pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion.

Në përputhje me të theksuarën më lartë, KRSKRR-ja edhe njëherë thekson se në përputhje me LSKRR-në, shofer fillestar është çdo shofer i mjetit motorik për një periudhë dyvjeçare pas marrjes së patentë shoferit, pavarësisht nëse e ka marrë patentë shoferin në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose jashtë saj.

Shoferi fillestar është edhe shofer i mjetit motorik në një periudhë dyvjeçare pas marrjes së patentë shoferit, nga kategoria e caktuar, pavarësisht nëse ka patentë shoferi për kategori tjetër.

"Doracaku për shoferët fillestarë" i hartuar nga KRSKRR-ja i përshkruan rregullat "më të rëndësishme" të komunikacionit që çdo shofer fillestar i kategorisë "B" duhet t'i dijë.

Fatkeqësitë e komunikacionit që ndodhin çdo ditë dhe jetët e humbura njerëzore në rrugë le të jenë paralajmërim për ju dhe përkujtim që komunikacioni kërkon përgjegjësi serioze, profesionalizëm dhe njohuri.

JINI TË PËRGATITUR DHE JINI PJESËMARRËS TË PËRGJEGJSHËM NË KOMUNIKACION!

LITERATURA E SHFRYTËZUAR:

1. Ligji për siguri në komunikacionin rrugor - ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 169/15, 226/15, 55/16, 11/18 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 98/19 dhe 302/20)
2. Rregullorja për shenjat që u jepen pjesëmarrësve në komunikacionin rrugor nga nëpunësit policorë të uniformuar të Ministrisë së Punëve të Brendshme ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 47/16)
3. Rregullorja për shenjat e komunikacionit, pajisjet dhe sinjalizimin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 174/20)

Botues:

Këshilli Republikan për Siguri në Komunikacionin Rrugor
www.rsbsp.org.mk

Për botuesin:

mr. Gordana Kozhuvarovska, kryetare

**DORACAK
PËR SHOFER FILLESTAR**

Autorë:

mr. Gordana Kozhuvarovska
mr. Zlatko Angellkovski
inxh. diplo. Riste Josifovski

Bashkëpunëtorë profesionalë:

Vladimir Llazarov
mr. Risto Maņev
inxh. diplo. komunik. Kiro Ristovski

Lektor:

Tatjana Lalek-Kulishevskaja

Përpunimi kompjuterik dhe kopertina:

Vesna Mundishevskaja-Veljanovskaja

Shtypi:

"Grafoprom" - Manastir

Shkup, 2021

copyright © KRSKRR, 2021

ISBN 978-608-4920-01-4





Републички
Совет за
Безбедност на
Сообраќајот на
Патиштата

www.rsbsp.org.mk

ISBN 978-608-4920-01-4